

Zaevi i vendosur
Emri në referendum

Fq.3



VAZHDOJNË KRITIKAT

Programi i botimit, më skandaloz i 24 viteve

Fq.5



Ka ardhur koha e Napolit


Hamshik

Fq.21



Koha

www.koha.mk



Çiklisti që shpëtoi 800 hebrenj

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3293 · e enjte 15 shkurt, 2018

0°C | +6°C

15 DEN

EDITORIAL

Bashkëpunimi ndëruniversitar dhe sot



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" sot shënon 48 vjetorin e themelimit. Për ndonjë shtet me traditë të gjatë emancipimi e arsimimi, një përvjetor i tillë nuk do të paraqiste ngjarje gjithaq të madhe, mirëpo për një vend si Kosova, me vështirësi historike e politike në rrugën e saj të shtetndërtimit, përvjetorët e tillë janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në dinamikën e përgjithshme të zhvillimit shoqëror e social. Ky universitet në të kaluarën ishte promotori i lëvizjeve politike e kulturore, si dhe pararojë e mendimit... Fq.2

RAJON

Serbia po i armatos serbët e Bosnjës

Fq.14

KULTURË

Gjenocidi serb përmes një monografie

Fq.17



ASKUSH NUK E DI KUR MUND TË NIS SEANCA PËR LIGJIN E GJUHËVE

VMRO KËRKON PAZAR PËR SHQIPEN!

Burime nga Parlamenti i Maqedonisë thonë se është shumë vështirë që partitë në pushtet të veprojnë në mënyrë unitare pa mos përfillur amendamentet e VMRO-së

Fq.3

Për çdo vit ikin 175 mjekë

Shkup, 14 shkurt - Rrogat e ulëta, motivim në rënie i mjekëve nga institucionet shëndetësore, kushtet jo të mira për punë në spitalet dhe klinikat shëndetësore shtetërore, janë arsyt kryesore që një numër i madh mjekëve të specializuar, kryesisht mjekë të rinj, i shtyn të ikin jashtë Maqedonisë dhe profesionin e tyre ta ushtrojnë në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore. Kështu tregojnë të dhënat e fundit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë (OMM), sipas të cilave nga gjithsejtë 220 mjekë të diplomuar vitin e kaluar në tre Fakultetet e Mjekësisë, 173 prej tyre kanë ikur jashtë vendit për të ushtruar profesionin. Nga OMM-ja shprehen tepër të brengosur për faktin se nëse institucio-

net përkatëse dhe Qeveria e Maqedonisë nuk ndërmarrin ndonjë masë konkrete për të mbrojtur mjekët që të mos... Fq.7



EDITORIAL

BASHKËPUNIMI NDËRUNIVERSITAR DJE DHE SOT



Emin AZEMI

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" sot shënon 48 vjetorin e themelimit. Për ndonjë shtet me traditë të gjatë emancipimi e arsimimi, një përvjetor i tillë nuk do të paraqiste ngjarje gjithaq të madhe, mirëpo për një vend si Kosova, me vështirësi historike e politike në rrugën e saj të shtetndërtimit, përvjetorët e tillë janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në dinamikën e përgjithshme të zhvillimit shoqëror e social. Ky universitet në të kaluarën ishte promotori i lëvizjeve politike e kulturore, si dhe pararojë e mendimit intelektual e shkencor për shumë procese që e përshkuan Kosovën. Nga ky universitet dolën kuadro të cilët më vonë do të bëhen bartës të lëvizjeve e veprimeve me karakter politik, social e ushtarak dhe konteksti i paraqitjes së këtyre figurave identifikohet me epokën independente të Kosovës, e cila sivjet shënon 10 vjetorin e shtetësisë së pavarur.

Për të realizuar objektivat e veta akademike e shkencore, një universitet e ka patjetër të bashkëpunojë edhe me universitet tjera në rajon dhe më larg. Universitetit i Prishtinës në të kaluarën, sidomos në vitet e shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta, madje edhe atëherë kur rrethanat politike nuk ishin si këto që i kemi tani, pati një bashkëpunim të frytshëm me universitetet tjera, sidomos me Universitetin Shtetëror të Tiranës. Duke qenë mikëpritës i shumë profesorëve visiting nga Tirana, Universiteti i Prishtinës jo vetëm që hapi dyert dhe katedrat për përvojat dhe dijet e tyre, por ai në këtë mënyrë shtroi edhe bazat e një bashkëpunimi më të gjerë kulturor, krijues e shkencor në mers të Kosovës e Shqipërisë. Profesorët e shquar si Eqrem Çabej, Aleks Buda, Rexhep Mejdani etj. të cilët ishin bërë shumë të dashur për studentët kosovarë, mbollën farën e shëndoshë për një fidanishte kuadrosh, të cilët më vonë do të bëhen bartës kryesor të procesit mësimor e shkencor nëpër fakultete dhe institute të Kosovës. Studentët e gjeneratave të mëhershme rrëfenin ngjarje shumë interesante që lidheshin me leksionet e pedagogëve nga Tirana dhe nuk ishin të paktë ata studentët të shkencave teknike, mjekësore e juridike që ndiqnin me ëndje ligjëratat e profesor Çabejt, profesor Budës apo të ndonjë tjetri.

Po sot si e kemi bashkëpunimin ndëruniversitar? Hiç ndonjë përjashtim të vockël, universitetet tona sot janë bërë shumë të vetëmjaftueshëm dhe kjo flet për mungesën totale të sensit për bashkëpunim dhe këmbim përvojash por edhe kuadrosh. Sot kur ka një liri maksimale të lëvizjes dhe një liberalizim të skajshëm të tregut të punës, universitetet tona janë shndërruar në kështjella të mbyllura mesjetare, në të cilat qarkullimi i kuadrove dhe projekteve është transformuar në njëfarë "lëvizje autonomiste universitare" që favorizon, gjoja, forcat vetanake akademike, por që në fakt shkërmoq idenë madhore për prurje më të mëdha të kuadrove nga njëri në universitetin tjetër. Fundja, modelet e bashkëpunimit dhe këmbimit midis universiteteve janë praktika të rrahura e provuara në rrugët e gjata të zhvillimit arsimor në botën e qytetëruar dhe nëse universitetet tona veprojnë kundër këtyre rrjedhave, ose vazhdojnë të jenë të mbyllur për ide e prurje nga jashtë, atëherë pasojat nuk bien vetëm mbi vetë ato universitete, por mbi krejt shoqërinë, e cila edhe ashtu po ndan bukur shumë mjete për të mbijetuar këto vatra arsimore.

Tani kur Universiteti i Prishtinës po kremton një përvjetor të rëndësishëm, ky mund të jetë edhe shkas për ta shikuar këtë ngjarje në kontekst të zhvillimit të përgjithshëm arsimor të shqiptarëve, duke nxjerrë mësim nga shembujt e mirë të bashkëpunimit në të kaluarën dhe duke flakur modelet e këqija të mbylljes dhe ekskomunikimit në ditët e sotme.

PËR FLAMURIN, PËR SHTETIN E KOSOVËS

"Loja me FLAMUJT (shtetërorin dhe kombëtarin) tregon frikshëm problemet tona serioze psikologjike e morale. S'jemi SHTET dhe s'e duam atë, sepse flamurin e tij e vendosim tinëz, natën, dhunshëm, kundër flamurit kombëtar, në mënyrë që po në terr, "kushdo" të mund ta heqë sërish atë në emër të KOMBËTARES. Në këtë përvjetor jubilar, Shteti i Kosovës vazhdon të jetë:

- arenë e garës për "patriotizmin" (ku përplasen kombëtaristët antipavarësishtë dhe pavarësishtë antikombëtaristët);
- "plaçkë" e pangopësisë së politikanëve (pozitë e opozitë) që janë të angazhuar (disa me e shumica pa vetëdije) për ta zhbërë shtetin;
- republikë karikaturë, pa rend e pa ligj, ku hajnia ka arritur majat, deri edhe te flamuri, në emër të Meritave e të Kontributeve Kombëtare, dhe ku profesorë, mjekë, ministra, deputetë... e kush jo, janë diagnostikuar si KLEPTOMANË;
- skenë tragjikomodie, ku budallai shet "mend", matrapazi është i "zoti", profesionisti "idiot" dhe i ndershmi i "paaftë".

Prandaj, në vend të provokimeve ditën e natën, në vend të aktrimeve për Lavdinë e Marrëzisë si Shpëtimtarë e Mashtrues, patriotët e të dy krahëve është mirë t'i lënë rehat FLAMUJT. Ata s'na kanë faj. Nëse festa e 10 vjetorit na është e zbehtë, s'na jep emocion, nuk ka faj flamuri.

Nëse kjo s'është Kosova që kemi dashur në 10 vjet SHTET, nuk ka faj flamuri, fajet i kemi vetë", shkruan në profilin e tij në FB, Arben Fetoshi.

QIPRO DHE FLAMURI I KOSOVËS

"Republika e Qipros, është shtet i pavarur, anëtarët i OKB-së, nga viti 2004 është anëtare i BE-së, por edhe pse gjendet shumë kilometra larg Greqisë, AS QË I SHKON MENDJA NDOKUJT të formon 'kombin qipriotë'. Qeveria e Qipros dhe populli i saj, lëre që nuk i hidhërohen Greqisë për kujdesin, por ata as që ndërmarrin diçka pa pëlqimin dhe udhëzimet e saj. Ata nuk debatojnë me Turqinë (si shtet armik i tyre) për asgjë pa pëlqimin dhe këshillat e Greqisë, bile Greqia flet dhe vendos në emër të tyre, pra në emër të vëllezërve të tyre grek në Qipro. Flamuri zyrtar i Qipros nuk i pengon qipriotët të mbrojnë me fanatizëm flamurin kombëtar grek. Himni i Qipros (Himni Lirisë), është plotësisht i njejtë siç e kanë edhe vëllezërit e tyre në Greqi. Ka edhe shumë shembuj që do na shërbenin neve shqiptarëve të mësojmë se idea e disa lepuroshave për krijimin e 'kombit kosovarë' është totalisht e panevojshme dhe teje e rrezikshme. Miq të nderuar në FB, Ju që jeni profesionistë në fushën e historisë, diplomacie, shkencave politike..., do ishte mirë t'i ndihmoni shqiptarëve që mos të bëhen pre e histerisë albanofobe të disa KUKUVAJKAVE SHQIPFOLËSE. Me anë të këtij shkrimi, vite më parë reagova kundër sojtit të Halil Matoshit, që sot për fat të keq është këshilltar i kryeministrit Haradinaj. Fatkeqësisht, ndarja brenda shqiptarëve dhe 'kosovarëve' veç ka filluar të shihet dhe ndjehet kudo. Nuk ndalet dot!", shkruan në profilin e tij në Facebook, dr.Selver Jashari.

MEDIACitate

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka quajtur gjykatën ndërkombëtare për krime lufte, me juridiksion ndaj të dyshuarve potencialë kosovarë, një "padrejtësi historike", duke shtuar se qeveria e Kosovës e pranoi atë me gjysmë zemre si "çmim për lirinë e saj". Në një intervistë për "The Associated Press", në prag të 10 vjetorit të Pavarësisë, Thaçi kritikoi ashpër Gjykatën Speciale, me bazë në Hagë, dhe e krahasoi atë me krijimin e një gjykate për t'i gjykuar hebrenjtë që janë persekutuar nga nazistët në Luftën e Dytë Botërore. "Kosova ka zhvilluar një luftë mbrojtëse për ekzistencë si komb dhe nuk ka sulmuar askënd", tha Thaçi. Gjykata Speciale ka juridiksion ndaj të dyshuarve potencialë për krime lufte në Kosovë, por ende nuk është marrë me asnjë rast.

(AP, 14 shkurt)

Që prej të hënës Thorsten Frei, raportuesi për Shqipërinë në Komisionin Parlamentar për Çështjet e Jashtme dhe Evropën në Bundestagun gjerman, zhvilloi takimet me qeverinë, opozitën dhe grupe të ndryshme interesi. Pa mohuar progresin që nga nëntori i 2016-ës, kur deklaruan në Tiranë 7 pritshmëritë për Shqipërinë, gjermanët kërkojnë të ashtuquajturit "peshqit e mëdhenj" para drejtësisë në këmbim të çeljes së negociatave për anëtarësim në qershor. "Në varësi të zhvillimeve në javët që vijjnë do të ndryshojë dhe opinioni ynë. Ne vlerësojmë efektet e para të vettingut me dorëheqjet nga sistemi, por presim më shumë. Sa i përket vettingut, goditjes së korrupsionit dhe krimet të organizuar, ne konstatojmë se ka progres që nga hera e fundit, por nuk kemi ende rezultate të mjaftueshme për rastet e mëdha, pra për "peshqit e mëdhenj". Për ne zbatimi i prioritetëve kyçe është kusht themelor për çeljen e negociatave për anëtarësim dhe në Gjermani për këtë vendos Bundestagu", deklaroi ai. Një minus të madh, sipas Frei, Shqipëria ka shënuar me mosheqjen e imunitetit të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri.

(Top Channel, 14 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ISHIN TERZINJTË?

Terzinjtë ishin zejtarë që merreshin me punimin e veshjeve, kryesisht në qytet dhe më pak në fshat. Pas pushtimit të Shqipërisë nga osmanët pësoi ndikime mënyra e veshjes së klasës sunduese dhe e një pjese të qytetarëve. Terzinjtë iu përshtatën kërkesave të reja. Prodhimet e tyre kryesore u bënë mitanet e jelekët, kaporana, dollomaja etj., të përgatitura me cohëra të

kushtueshme e të qëndisura me motive artistike vendase. Në shek.XVII-mesi i shek.XIX mjeshtëria e terzinjve arriti lulëzimin e vet me zhvillimin e jetës qytetare.

Terzinjtë formuan esnafet e tyre të veçanta. Puna e tyre pati një rol të rëndësishëm në formimin e tipareve kombëtare të veshjeve shqiptare.

ASKUSH NUK E DI KUR MUND TË NIS SEANCA PËR LIGJIN E GJUHËVE

VMRO KËRKON PAZAR PËR SHQIPEN!



TODOR PENDAROV

Unë shpresoj se partitë parlamentare do ta kuptojnë se në çfarë momenti ndodhemi tani edhe si shtet, edhe si shoqëri edhe si qytetarë dhe se do të gjejnë zgjedhje politike për këtë. Si do të jetë ajo zgjidhje politike, nuk mund të prejudioj, por sidoqoftë në mënyrë institucionale dhe me Rregullore - kjo është e bllokuar

do të dënohen dhe nëse LSDM garanton se gjuha shqipe nuk do të përdoret në të gjithë territorin e vendit, gjithçka do të jetë në rregull për përkrahje të Qeverisë në procesin e integrimi dhe gjetjes së zgjidhjes për emrin", thonë burime anonime të afërta me Kryesinë e re partiake. Ndërkaq, kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickosvki, gjatë takimit të së mërkurës në Beograd me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Ligji për përdorimin e gjuhëve e çon prapa Maqedoninë. Ndryshe, eksperti juridik dhe njohësi i mirë i procedurave parlamentare, Todor Pendarov, thotë se është e padryshme nevoja e sjelljes së këtij ligji, por me 35 mijë amendamentet e VMRO-së, zgjidhja e shpejtë mund të jetë vetëm politike. "Nëse fillohet sipas procedurës që e kërkon Rregullorja, atëherë së paku katër ose pesë muaj Parlamenti duhet të merret vetëm me 35 mijë amendamentet. Do të thotë duhet të gjendet zgjidhje politike. Unë shpresoj se partitë parlamentare do ta kuptojnë se në çfarë momenti ndodhemi tani edhe si shtet, edhe si shoqëri edhe si qytetarë dhe se do të gjejnë zgjedhje politike për këtë. Si do të jetë ajo zgjidhje politike, nuk mund të prejudioj, por sidoqoftë në mënyrë institucionale dhe me Rregullore - kjo është e bllokuar", ka theksuar Pendarov.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 14 shkurt - Krahas vëmendjes së opinionit drejt zgjidhjes së çështjeve të emrit me Greqinë, Ligji për gjuhët pritet të problematizojë përsëri skenën politike në rast të mos gjetjes së zgjidhjes politike për ligjin në fjalë. Javën e ardhshme, grupet e punës të LSDM-së dhe VMRO-së ka gjasa të dalin me marrëveshje për ligjet që prekin reformat në sferën e sigurisë dhe ato në sferën e gjyqësorit. Ndërkaq lidhur me Ligjin për gjuhët, grupet e punës - sipas informative jozyrtare, nuk do të dalin me ndonjë rezultat konkret. Nga ana tjetër, me interes është ajo se si do të veprojnë kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, do ti përmbahet zotimit se nuk do të thërras seancë plenare pa mos u pajtuar të gjitha palët lidhur me Ligjin për gjuhët, apo do lëshojë pe. Burime nga Parlamenti i Maqedonisë thonë se është shumë vështirë që partitë në pushtet të veprojnë në mënyrë unitare pa mos përfillur amendamentet e VMRO-së, duke shtuar se kryeparlamentari Xhaferi

Burime nga Parlamenti i Maqedonisë thonë se është shumë vështirë që partitë në pushtet të veprojnë në mënyrë unitare pa mos përfillur amendamentet e VMRO-së

ende kujtohet për vjershat që recitonte në Komisionet parlamentare për të mos kaluar "Ligji i Branitellave". "LSDM nuk mund ta bind aq lehtë VMRO-në për tu tërhequr nga amendamentet kur deputetët tanë ende janë në burg, pra kjo është një gjë që s'bëhet. Ata nuk mund ta shkelin Rregulloren as nuk mund të akumulojnë diskutimet në një amendament, sepse çdo amendament do të hap diskutim", thonë deputetët të VMRO-së. Nga ana tjetër, burimet tjera parlamentare thonë se grupi i të pakënaqurve që përfa-

qësohet nga deputetët Ilija Dimosvki dhe Antonio Milloshovski janë ata që po këmbëngulin për shqyrtimin një nga një të amendamenteve deri sa të gjendet një kompromis për kolegët e tyre të burgosur: Kërste Mukosvki dhe të tjerët. "Lideri Hristijan Mickosvki nuk është i interesuar të bllokojë Parlamentin siç kanë bërë më herët. Ai do të përkrah reformat në vend, por kërkon përgjigje nga LSDM lidhur me fatin e deputetëve të burgosur. Nëse e merr përgjigje pozitive për deputetët e burgosur, konkretisht se nuk

LIKA PRANON SE KA EDNE PUNË DERI NË MIRATIMIN E LIGJIT TË SHQIPES

Nga BDI, Hazbi Lika, zëvendëskryeministër për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, ka thënë në emision "Click Plus" në TV 21 se ende ka punë për të bërë deri në sjelljen e Ligjit për gjuhët, duke iu referuar leximit të tretë, gjegjësisht 35 mijë amendamenteve të VMRO-së. "Kemi shumë punë deri në miratimin përfundimtar të këtij ligji. Nuk duhet të jemi shumë entuziastë, pasi jemi në pritje të seancës në Parlament për Ligjin. Në Parlament ka të parashtruara shumë amendamente për këtë ligj, ata duhet të shqyrtohen mirë dhe pa votimin e tretë të ligjit në Parlament, nuk mund të themi se kemi kryer punën", ka theksuar Lika. Por nga grupi



parlamentar i BDI-së, sipas informatave që posedon gazeta KOHA, me LSDM-së është shqyrtuar mundësia që amendamentet e VMRO-së të hidhen poshtë si teknikisht të pabaza me që është harxhuar debate për amendamentet në lexim të dytë. Ose varianti tjetër - të mos merren për bazë vërejtjet e presidentit me që nuk janë në pajtim me Kushtetutën e vendit. Nga LSDM nuk pranojnë të flasin lidhur me këto variante, por thonë shkurt se Ligji për gjuhët do të kalojë pa u ndryshuar, por duke mos përjashtuar ndryshimet nëse Komisioni i Venedikut do të vlerësojë se Ligji në tërësi ose disa pjesë të tij nuk është në pajtim me Kushtetutën.

Negotinë, 14 shkurt - Dinjiteti dhe identiteti janë shumë të rëndësishme në negociatat me Greqinë, theksoi mes të tjerash kryeministri Zoran Zaev, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve gjatë vizitës së djeshme në Negotinë. Ai tha se nuk do të theksojë hollësi, për, siç theksoi, të mos dalë se po negociohet përmes mediave. "Ndërmjetësuesi Nimic e udhëheq procesin, ai i di në thelb gjërat të cilat mund të kalojnë dhe cilat nuk mund të kalojnë tek njëra palë dhe tek pala tjetër. Është e rëndësishme që të ndërtohet besimi midis të dy palëve në funksion të zgjidhjes së problemit. Mua më vjen mirë që janë zbrërthyer në esencë të gjithë çështjet e hapura. Nëse nisemi nga ajo që fillimisht nga shtatë pozicionet të cilat ishin pika referimi

EMRI NË REFERENDUM

Zaevi pret që të dyja palët të jenë pragmatike, ndërsa zgjidhja eventuale, përsërit ai, të konfirmohet në referendum

për bisedimet, tanimë janë zvogëluar në katër pozicione, tre janë mënjeluar. Unë besoj se me politikën e Qeverisë së re shumë shpejt do të mund të zbrërthehen edhe pozicionet e tjera", deklaroi Zaev. Ai potencoi se Republika e Maqedonisë dëshiron zgjidhje, ndërsa Qeveria, siç theksoi, bën

plotësisht gjithçka, përpiqet të ndërtojë konsensus të brendshëm në shtet, në funksion të gjetjes së zgjidhjes përfundimtare. "Me të vërtetë jemi optimistë për gjetje të zgjidhjes. Gjithsesi se dërgohen mesazhe të caktuara nga partneri ynë nga pala greke, për linja të caktuara dhe ngjashëm, unë besoj se duhet të gjejmë zgjidhje për të mirën e qytetarëve të së dy vendeve. Nëse jemi me të vërtetë optimistë në këtë proces, nëse dëshirojmë me të vërtetë sinqerisht të gjendet zgjidhje, kjo është e mundur, procesi ka periudhë kohore para vetes. Shpresoj se çdo hap i

ardhshëm do të na afrojë në pjesën e të gjithë atyre çështjeve të cilat janë të hapura, ndërsa plotësisht duhet të jenë urë bashkimi dhe gjetje e zgjidhjes përfundimtare të problemit me emrin që Republika e Greqisë e ka me emrin tonë kushtetues", tha Zaev, duke bërë thirrje që t'i jepet shans procesit të negociatave. Qytetarët, shtoi Zaev, e dinë se cilat janë qëndrimet e Maqedonisë lidhur me atë dhe me çështjet e tjera, por duhet të jemi të kujdesshëm dhe t'i jepet mundësi procesit për arritje të zgjidhjes. Lidhur me përcaktimin gjeografik, konfirmoi se është opsion i pranue-

shëm për palën e Maqedonisë dhe përkujtoi se përmenden disa emra. "Kjo nënkupton se për ne është i pranueshëm emër me përcaktim gjeografik, gjegjësisht i hedhim poshtë të gjithë emrat e tjerë të cilët ishin me përcaktim kohor, ose disa të tjerë të cilët ishin si propozime", informoi kryeministri. Pret që të dyja palët të jenë pragmatike, ndërsa zgjidhja eventuale të konfirmohet në referendum. "Dashtë Zoti të vijmë deri në zgjidhje që të mund të dalim në referendum", është decid Zaev. Projekt marrëveshja, tha, është një prej veglave, bëhen skicime të caktuara për zgjidhje të mundshme, ndikime ndaj të dyja palëve, se si kjo do të ishte e pranueshme nga qytetarët e të dyja palëve, nga institucionet dhe ngjashëm.

PARADOKSET E PROGRAMIT 2018

300 MIJË PËR CD, 80 MIJË PËR FESTIVAL!



Koha Evis HALILI

RAMI MUSTAFA

Shkup, 14 shkurt - Metodologjia e financimit të projekteve shqiptare në Sektorin e muzikës dhe veprimtarisë skenike, aty ku këtë vit Ministria e Kulturës ka rritur buxhetin, përmban një sërë paradoksesh. Para që derdhen pa kursyer për koncerte, promovime, emra dhe shoqata që konkurrojnë për herë të parë dhe nga ana tjetër - manifestimet tradicionale dhe emra të njohur të skenës janë përkrahur në nivelet më ekstreme minimale. Kriteret janë të tilla që nëse për realizimin e një kënge që interpretohet nga një i mitur jepen 300 mijë denarë (shumë kjo e njëjtë me atë që është kërkuar), për një festival tradicional për fëmijë si "Ylberi" - maksimumi që jep Ministria është vetëm 80 mijë denarë. Ajo që vihet re tek listat e publikuara me projektet që do të realizohen kanë një fitues të përbashkët - qytetin e Tetovës, aty ku do të zhvillohet numri më i madh i aktiviteteve. Më mirë të financuara janë projektet e shoqatave si "Alegretto", apo "Event", të cilat këtë vit janë zhvendosur në sektorin e manifestimeve, për festivalet e të cilave do të ndahen me nga tre milionë denarë. Lidhja e Artistëve Shqiptarë është mbështetur me një shumë mbi 900 mijë de-

Qëndrimi im është kundër këtyre rezultateve, pasi nuk është respektuar mendim im profesional dhe nuk është marrë parasysh vlerësimi profesional i bërë si anëtar komisioni nga ana e ministrisë. Kjo është arsyeja që kjo listë me këto fitues nuk e mban nënshkrimin tim. Me këto rezultate jam i bindur se duhet të fillojnë reformat për decentralizimin e kulturës shqiptare, nga Tetova ku do të përqendrohet këtë vit edhe nëpër qytetet e tjera shqiptare

narë për një projekt, manifestimet folklorike ku monopoli i aktiviteteve mbahet nga disa shoqëri dhe ansamble. Sa i takon shumave të ndara për interpretime solistike, shifrat arrijnë edhe deri në 300 mijë denarë, ndërsa për një duo artistësh nuk jepen më shumë se 20 mijë denarë. 300 mijë denarë po ashtu janë ndarë edhe për shoqatën për arsim, kulturë e shkencë "Vigan" nga Tetova për një koncert të një 12 vjeçari në Qendrën e Kulturës, shumë kjo e njëjtë me Besiana Mehmetin për interpretimin e Stabat Mater në Katedralen Katolike. Por jo të gjithë artistët kanë trajtim të barabartë, ashtu siç ndodh në këto raste, ku shumë projekte të ngjashme kanë marrë dhjetë herë më pak para.

Me projektet që ka vendosur të mbështesë Ministria e Kulturës, por edhe ato të tjera që ka refuzuar,

mbështetja që po i jepet kulturës shqiptare dhe manifestimeve tradicionale ka ngritur shumë pikëpyetje mbi politikën e këtij institucioni. Sa i takon festivaleve për fëmijë, të cilat kanë marrë shumë më pak nga çfarë kanë kërkuar, një shumë standarde prej 80 mijë denarë e njëjtë për të gjithë, ose shumë më pak krahasuar me manifestimet e ngjashme tek pjesa maqedonase që marrin deri në 300 mijë denarë.

"Kjo shumë e ndarë është jashtëzakonisht e vogël, e njëjtë me atë që na është dhënë zakonisht. Ky trajtim që na bëhet ne, si një festival me traditë shumëvjeçare është irritues, pasi jo vetëm që na dallon nga pjesa tjetër, por edhe na barazon me ato festivale që kanë pak vjet eksperiencë. Këto vendime politike dhe kjo traditë e Ministrisë së Kulturës duhet të ndërpr-

Kjo është edhe një prej arsyeve që këto rezultate nuk mbajnë as miratimin e anëtarit shqiptar, Rami Mustafa, i cili shton se me shumicën e projekteve fituese - nevojitet decentralizimi i kulturës shqiptare nga Tetova drejt qyteteve të tjera

EDHE "MEGJASHI" KËRKON TRANSPARENÇË

Ambasada e parë e fëmijëve "Megjashi" në reagimin e hapur drejtuar Ministrisë së Kulturës kërkon që të deklarohet për mënyrën sesi financohen projektet e Programit të Kulturës së 2018, me theksin tek projekti për financimin e një disku CD "Pëllumbat e lirisë", shuma dhe përmbajtja e të cilit shkaktoi reagime. "Megjashi" kërkon që ky rast të shikohet pa referencë etnike, por sipas standardeve dhe normave shoqërore dhe se si kërkohet të funksionojnë institucionet, mënyrën e aplikimit dhe ato rregulla të vlejshme për të gjithë njëllot. "Pavarësisht se për kë bëhet fjalë në këngë dhe pavarësisht përkrahjes të cilën e kanë nga prindërit dhe fëmijët të cilën kyçen në aktivitete të këtyra, do të donim të theksojmë se veshja e fëmijëve me uniforma ushtarake nuk kontribuon në ndërtimin e paqes dhe një bote të mirë për fëmijët. Numri i madh i reagimeve negative me rastin e ndarjes së fondeve tregon se procesi dhe vendimet e Ministrisë për pjesën më të madhe të qytetarëve është i dyshimtë, çka automatikisht kërkon transparencë dhe llogaridhënie nëse duam të ndërtojmë një shoqëri ndryshe", thuhet në reagim.

tet dhe në përzgjedhjen e fituesve duhet të merren parasysh edhe kriteret e profesionalizmit. Ne e duam këtë punë që bëjmë, investojmë dhe prandaj arrijmë ta realizojmë çdo vit, jo për shkak se na mbështet ministria", thotë Adem Imeri nga festivali "Ylberi".

Kjo është edhe një prej arsyeve që në Komisionin e muzikës, anëtarit shqiptar, Rami Mustafa pohon se me këto rezultate nevojitet decentralizimi i kulturës shqiptare, nga Tetova për në qytetet e tjera. Mustafa nuk jep sqarime lidhur me kriteret që janë vendosur për përzgjedhjen e fituesve, pasi kjo listë nuk mban nënshkrimin e tij.

"Qëndrimi im është kundër këtyre rezultateve, pasi nuk është respektuar mendim im profesional dhe nuk është marrë parasysh vlerësimi profesional i bërë si anëtar komisioni nga ana e ministrisë. Kjo është arsyeja që kjo listë me këto fitues nuk e mban nënshkrimin tim. Me këto rezultate jam i bindur se duhet të fillojnë reformat për decentralizimin e kulturës

shqiptare, nga Tetova ku do të përqendrohet këtë vit edhe nëpër qytetet e tjera shqiptare", thotë Mustafa. Sekretari shtetëror Vlamiir Aziri ende nuk ka dhënë sqarime publike lidhur me rezultatet e konkursit, fituesit, përqindjet e financimit, e të tjera. I kontaktuar, Aziri ka thënë se do të deklarohet të enjten.

NË VEND TË SQARIMIT

Në numrin e djeshëm të gazetës sonë na është përvjedhur një lëshim i natyrës teknike, për çka kërkojmë ndjesë nga lexuesit. Bëhet fjalë për shkrimin me titull "300 mijë për CD, 80 mijë për festival", i cili edhe pse ishte i paralajmëruar në ballinën e gazetës, i njëjti nuk ka dalur në fq. 8, aty ku edhe ishte i planifikuar. Në procesin e finalizimit grafik, kjo faqe është ngatërruar më një tjetër dhe si e tillë ka ngelë e papërfshirë në gazetë, ndaj të njëjtën sot po e përsërisim.

Redaksia e gazetës KOHA

MATEMATIKA E GABUAR E AZIRIT

Ndaj akuzave për ndarjen e padrejtë të mjeteve të Ministrisë së Kulturës, sekretari shtetëror në këtë ministri, Valmir Aziri, është munduar të arsyetohet duke u thirrur në sasinë e mjeteve që, sipas tij, do t'i takojnë projekteve shqiptare. "Për ata që ankohen, kur buxheti i Ministrisë së Kulturës për shqiptarët është mbi 30% nga 1.7 miliardë denarë i pyes publikisht, çfarë shikoni në këtë foto?, ka pyetur Aziri. Megjithatë, shifrat për aktivitetet kulturore në lëminë e muzikës përgjeshetrojnë këto matematika të Azirit. Nga 95 milionë denarë sa janë paraparë për të përkrahur projekte muzikore, prej tyre vetëm 10.750.000 denarë shkojnë për muzikën shqiptare, ose me përqindje kjo i bie afër 11%.



“Tregu i punës është ai që dikton jo vetëm zhvillimin ekonomik të një vendi, por edhe orientimin e politikave arsimore e përtë cilat universitete kanë një rol të madh”, thotë profesori universitar Neritan Turkeshi

SFIDA E UNIVERSITETEVE TË SOTME

KUADRO MOBILE DHE PROGRAME FLEKSIBILE



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 14 shkurt - Mësimi i anglishtes si dhe përdorimi i teknologjisë informatike, krahas përgatitjes profesionale dhe pajisjes me kompetencë dhe me shkathtësi profesionale, të cilat korrespondojnë me kualifikimet e caktuara - nuk ka dyshim se përbëjnë çelësin e suksesit për një vend më të mirë pune dhe me perspektivë. Por që këta persona të mund ta gjejnë veten në tregun e punës është mëse e nevojshme që edhe universitetet t'u përshtaten atyre kërkesave dhe këtë mund ta bëjnë mjaft mirë nëse ofrojnë programet përkatëse studimore. Mobiliteti në kuadro dhe fleksibiliteti në programe studimore duhet të jenë elementë të rëndësishëm. Universitetet duhet ta pranojnë këtë si sfidë, u tha mes tjerash në trajnimin me këtë tematikë të zhvilluar në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Si element tepër i rëndësishëm u theksua nevoja për përgatitjen e kuadrove për një treg më të gjerë, që tejkalojnë kufijtë nacional dhe rajonal. Për shembull, Gjermania, e cila është një treg i gjerë, ka ne-

"SMEA" DO TË PADIT SASHK-un

Sindikata Multietnike e Arsimit (SMEA) paralajmëroi se do të shtrojë kallëzim penal kundër Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SASHK) për shkak të letrës së dërguar drejtorëve të shkollave me të cilën bëhet presion ndaj të punësuarve të cilët janë anëtarë të SASHK. Kryetari i SMEA, Dragi Jovanovski sot në konferencë shtypi tha se me letrën SASHK bën presion klasik ndaj të punësuarve të cilët janë anëtarë të SASHK që të mos mund të heqin dorë

vojë për 50.000 kuadro informatikanësh dhe, pse kuadrot nga Maqedonia të mos e synojnë atë treg kur dihet niveli i roqave dhe mirëqenia e atij shteti. Por që të punësohesh në Gjermani dhe ne cilindo shtet tjetër të Evropës, duhet njohja në nivele të lakmueshme e anglishtes. “Tregu i punës është ai që dikton jo vetëm zhvillimin ekonomik të një vendi, por edhe orientimin e politikave arsimore e për të cilat universitetet kanë një rol të madh”, thotë profesori universitar Neritan Turkeshi. Në këtë pikë, ai veçon UNT-në si institucionin i cili

spikat në orientimin e programeve studimore në vizatime të kërkesave të tregut. Madje, ky universitet, sipas tij, vazhdon të kryesojë bindshëm me ofrimin e studimeve nga shkencave ekzakte dhe numrin me programeve të akredituara studimore. “Ekzaminimi i nevojave të tregut dhe ofrimi i programeve përkatëse studimore, besoj se do të sjellin suksesin e nevojshëm për të gjithë ne”, shprehet Turkeshi. Me hapjen e drejtimeve të shkencave ekzakte, në UNT, plotëson më tej ai, ne bëhemi pjesë e sistemit të modernizimit të arsimit dhe pjesë

nga anëtarësia e sindikatës. Akuzoi se në periudhën e kaluar SASHK në vend se t'i çojë përpara i ka çuar në regres të drejtat e punonjësve të arsimit. Jovanovski paralajmëroi se si SMEA do të angazhohen për kthimin e të drejtave dhe dinjitetit të punonjësve të arsimit, për pagesën e K-15, për avancimin në karrierë, kthimin e dialogut social dhe nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive. Sindikata SMEA është edhe kundër rritjes së kufirit të moshës për pensionim.

integrale e hapësirës evropiane arsimore. Kohëve të fundit, siç shpjegon profesori tjetër universitar Murtezan Ismaili jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë vërehet një konfuzitet lidhur me çështjen se çfarë duam të bëjmë, çfarë studentësh kërkojmë të nxjerrim dhe cilat janë nevojat e tregut. Edhe pse sipas tij bëhen përpjekje herë serioze e herë jo që të përgatisim kuadro sipas nevojave që ka shoqëria dhe në bazë të kërkesave të tregut, prapë se prapë kjo mbete një sfidë e vazhdueshme për shkencën të ndryshme sidomos ato të informa-

tikës ku thuhet çdo ditë dalin programe dhe teknologji të reja. Prandaj, duhet të lihen anash metodat klasike të studimeve dhe të orientohemi drejt nevojave të tregut edhe atë në planin afat shkurtër, sepse nuk mund ta dimë që tani se çfarë kuadros do ti duhen tregut pas 10 viteve, nënvizon profesor Ismaili. Mobiliteti në kuadro dhe fleksibiliteti në programe studimore duhet të jenë elementë të rëndësishëm, plotëson ai.

Stefan Peter, përfaqësues i EVN për Maqedoninë vëren se është shumë e rëndësishme të shihet se çfarë vendi zë praktika në kurrikulën e programeve studimore, pra se si implementohet ky dimension brenda një universiteti. Kjo, sipas tij tregon që kurrikula është përgatitur nga akademikët dhe sektori i biznesit me çka do t'ju ndihmon studentëve të përfitojmë më shumë praktikë dhe në të njëjtën kohë t'ju lehtësohet rruga për punësim në sektorin e biznesit.

VIJOJNË REAGIMET KUNDËR MINISTRISË SË KULTURËS

PROGRAMI I BOTIMIT, MË SKANDALOZI I 24 VITEVE

Koha Evis HALILI

Shkup, 14 shkurt - Tumoret e fshikëzës së urinës, Inxhinieria softuerike, Mbrojtja e mjedisit, Kalimet kufitare dhe turizmi, Frutat dhe perimet, Diabeti, Sëmundjet gjentale..., janë disa prej titujve të librave, të cilat do të financohen nga Ministria e Kulturës në Programin e këtij viti, në sektorin e Botimit. Përzgjedhja e titujve, por edhe e aplikantëve që nuk janë shtëpi botuese, apo edhe subjekte - veprimtaria e të cilave nuk përfshin botimin dhe lidhjet me letërsinë, janë disa prej vërejtjeve të cilat shtëpia botuese “Shkupi” ia ka drejtuar Ministrisë së Kulturës, përmes një letre të hapur. Sipas Azam Dautit, drejtorit të “Shkupi”, rezultatet e këtij konkursi, sidomos ato të Botimit janë më skandalozet gjatë këtyre dy dekadave dhe se 80 për qind e atyre librave të kaluara në gjuhën

“Shkupi” në një letër drejtuar Allagjozovskit kërkon të verifikohet situata dhe kush po abuzon në emër të Ministrisë së Kulturës, me theksin tek librat në gjuhën shqipe

shqipe, nuk i kanë plotësuar kriteret elementare për shqyrtim. Dauti shton se situata është edhe më drastike kur nga një familje kemi 3-4 shtëpi botuese që përfitojnë nga këto rezultate. “Shkupi” kërkon rishikimin e rezultateve dhe korrigjimin e lëshimeve. “Në këtë mënyrë do të shihet nëse dikush në emër të Ministrisë ka keqpërdorur Komisionin për Veprimtari Botuese për ndonjë lloj proteksionizmi të qël-

limtë ose të paqëllimtë, ose për interesa të tjera që s'kanë lidhje me veprimtarinë krijuese. Me këto aktivitete pa kritere, jo vetëm që është dëmtuar dhe nënçmuar programi ynë botues, por është dëmtuar edhe imazhi i udhëheqësisë së tashme të Ministrisë së Kulturës, e cila deri dje akuzonte pararendësit për keqpërdorime të parave popullore”, ka thënë Dauti. Ai ka përmendur edhe padrejtësitë gjatë miratimit të programit botues të “Shkupi”, që përmban vetëm tre tituj me shuma simbolike. Në listën e projekteve të miratuara nga Ministria e Kulturës, përveç shtëpive botuese, një pjesë prej të cilave me aktivitet relativisht të ri, janë mbështetur financiarisht edhe shoqata tregtare dhe prodhuese, shtypshkronja, shoqata që ofrojnë shërbime të ndryshme, universitete, disa prej të cilave me nga dhjetë tituj. Në shumë raste, personat fizikë kanë përfituar më

shumë para për botim sesa një shtëpi botues.

“I nderuar z.Ministër, është e vërtetë që Ju nuk jeni 'sulltani që pret', por ju gjithsesi e dini se gjithçka që ndodh në Ministri, përgjegjës është ministri dhe jo të tjerët... Prandaj, nëse dëshiron që Ministria ta ruajë imazhin të cilin pretendon ta ruajë, se kujdeset për shpërndarjen e mjeteve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për ata që meritojnë, duhet ta bëni hapin e parë dhe para se të nënshkruani kontrata me botuesit, të rishikoni në mënyrë publike para palëve të interesuara, se a i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara nga Ministria këto 535 projekte për aplikim”, thotë Dauti në letrën e hapur. Ankesa për veprimtarinë botuese ka pasur edhe nga botues të tjerë dhe autorë, të cilët kanë vërejtje për shumën e ndara dhe formën e padrejtë të financimit, që



ka arritur në minimumet e 50-60 mijë denarëve, shumë kjo minimale për botimin e një libri. Ndryshe ka ndodhur me disa shtëpi botimi, si Arbëria Dizajn, Litera Grup, të cilat numërojnë deri në nëntë projekte të miratuara, ku si një prej projekteve më të paguara ka “Tumoret e fshikëzës së urinës” me 200 mijë denarë... Si aplikues dhe projekte që lidhen më së pakti me artin dhe kulturën janë edhe ato të Komitetit të Helsinkit, Universitetit “Nënë Tereza”, Qendër e shërbimit të Kongresit..., e të tjera janë po ashtu aplikantë që kanë fituar të drejtën për të botuar libra, kryesisht shkencorë.

Hyn në fuqi Marrëveshja me Bullgarinë

Shkup, 14 shkurt - Shefi i diplomacisë së Maqedonisë, Nikolla Dimitrov dhe kolegja e tij bullgare Ekaterina Zaharieva të mërkurën në Sofje do të nënshkruajnë Protokoll për këmbimin e dokumenteve të ratifikimit, me çka zyrtarisht në fuqi do të hyjë Marrëveshja për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim të dy vendeve. Me këtë praktikisht do të përfundojë procedura formale për të hyrë në fuqi Marrëveshja, pas ratifikimit të saj në Kuvendin e Maqedonisë më 15 janar dhe në Parlamentin bullgar tre ditë më vonë.

Marrëveshja, siç njoftoi paraprakisht MIA, u nënshkrua më 1 gusht të vitit 2017 nga ana e kryeministrave të dy shteteve, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov, për shkak të përfundimit të marrëdhënies të ndërsjella miqësore, avancimin e fqinjësisë së mirë, zhvillimin e marrëdhënies të gjithanshme në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Marrëveshja është rezultat i procesit negociues pesëvjeçar i grupeve të punës të dy MPJ-ve dhe parqet sendërtim të marrëveshjes së nënshkruar në vitin 1990. Dimitrov prej dje po qëndron për vizitë pune në Sofje, ku është paraparë të ketë takime bilaterale me përfaqësuesit e autoriteteve bullgare. Shefi i diplomacisë së Maqedonisë sot, përveç me Zaharievën do të takohet edhe me presidentin e Bullgarisë, Rumen Radev dhe kryeministrin Bojko Borisov.

Ai prej sot merr pjesë në takim joformal të ministrave të punëve të jashtme të BE-së. Gjendja në Ballkanin Perëndimor, me theks të procesit eurointegruar të rajonit, si dhe situata në Siri dhe në Korenë Veriore, do të jenë temat në të cilat do të diskutohet në sesionet e takimit joformal të Këshillit për punë të jashtme të BE-së (Gimnih), që nesër dhe pasnesër do të mbahet në Sofje. Nikoqiri i takimit është zëvendëskryeministrja bullgare dhe ministre e Punëve të Jashtme, Ekaterina Zaharieva, vendi i së cilës është kryesues aktual me BE-në. Në takimin joformal do të marrë pjesë edhe përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federika Mogherini, shefat e diplomacive të 28 vendeve anëtare, si dhe ministrat e punëve të jashtme të pesë vendeve kandidate nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

PALA MBROJTËSE E GRUEVSKIT ME OBSTRUKSIONE TË NDRYSHME

"TRAJEKTORJA" ASSESI TË NIS

Prokurorja Stefanova akuzoi se avokatët e Gruevskit qëllimshëm duan të prolongohen seancat dhe lëndët të mos fillojnë

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 14 shkurt - Mos dhënia e procesverbaleve të shkruara dhe atyre të xhiruara, ishte arsyeja e radhës se pse pala mbrojtëse e të akuzuarve në rastin "Trajektorja", e kontestoi fillimin e procesit gjyqësor kundër Nikolla Gruevskit dhe ish funksionarëve tjerë të akuzuar në këtë lëndë. Avokati i ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, Dimitar Dankov, para fillimit të seancës për lëndën "Trajektorja", trupit gjykues në krye me gjykatësin Goran Boshevski ju drejtua se mbrojtjen e tyre nuk mund ta përgatisin në kohën kur nuk respektohet Ligji për procedurë penale. Reagimit dhe kundërshtimi të avokatit Dankov iu bashkëngjiti edhe kolegu i tij, Donçe Nakov, i cili theksoi se në opinion është plasur lajmi se ato janë shkaku kryesor se pse prolongohen seancat. Në prezencë të një numri të madh të mediave dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, avokati Nakov nënvizoi se mos respektimi i dispozitave të LPP-së, në shumicën e lëndëve ku merr pjesë ai dhe të cilat janë të iniciuar nga PSP, e kanë shtyrë të mendoj seriozisht për t'u larguar nga këto lëndë gjyqësore. Vërejtje tjetër e ekipit të avokatëve në rastin "Trajektorja" ishin edhe dëshmitë e propozuara nga PSP, gjegjësisht sms-porositë që, sipas tyre, nuk duhet të jenë pjesë e kësaj procedure. Njëkohësisht, ata i kontestuan edhe "bombat" e publikuara deri më tani për marrëveshjen e arritur për ndërtimin e autostradave Milladinovcë-Shtip dhe Kërçovë-Ohër. "Nga vetë fakti se këto materiale janë bërë publike dhe të njëjtat janë siguruar në mënyrë joligjore, kërkojmë që këto dëshmi të refuzohen. Ndërprerja e kësaj seance është e nevojshme, për arsye se ne nuk i kemi pranuar procesverbalet, aq më pak edhe CD-të nga seanca e mbajtur më 31 janar të këtij viti. Po ashtu, kërkojmë refuzimin e të gjitha provave që burojnë nga SMS-porositë, për shkak se Ligji parasheh që asnjë i pafajshëm nuk mund të dënohet", tha, mes tjerash avokati Dimitar Dankov në elabrorimin e tij.

Ashtu si edhe në rastet tjera, edhe kësaj radhe përfaqësuesit e PSP-së kanë vlerësuar se ky lloj i reagimeve dhe kundërshtimeve të



avokatëve mbrojtës në rastin "Trajektorja" bëhet me të vetmin qëllim që ky proces gjyqësor të mos fillojë. Prokurorja speciale, Lile Stefanova, pasi i dëgjoi reagimet e këtyre avokatëve, tha se për çdo seancë, ku si palë paraqiten ato, fjalimet e palës mbrojtëse çdoherë përsëriten.

"Reagimet e avokatëve pothuajse janë identike në çdo seancë. Dëshmitë janë dorëzuar dhe për të njëjtat gjykata ka miratuar vendim. Ne ende nuk e kemi filluar shqyrtimin kryesor, nuk i kemi thënë fjalët hyrëse dhe për këtë arsye - nuk ekziston asnjë shkak se pse të prolongohet shqyrtimi kryesor. Të gjitha dëshmitë tona ua kemi dorëzuar të akuzuarve. Bisedat telefonike dhe sms-porositë i kanë pasur në dispozicion dhe deri më tani - nëse kishin shprehur interes, do t'i kishin dëgjuar për më tepër se tre herë. Vërejtja ime rreth kësaj situatë të krijuar është se të gjitha këto zhvillime bëhen me të vetmin qëllim të anulohet fillimi i këtij procesi gjyqësor", tha prokurorja speciale, Lile Stefanova. Ndryshe, seancave të fundit, ndonëse ende nuk i ka ardhur radhë të prononcohet, i akuzuari Nikolla Gruevski shpeshherë është përfshirë në diskutim

MERCEDESI, SIMBOL I HARXHIMIT JOTRANSPARENT DO TË SHKOJË NË ANKAND

Simboli i harxhimit jotransparent që e bënte qeveria e kaluar, "mercedesi" pas vendimit të djeshëm të Qeverisë, do të shkojë në ankand publik me çmim fillestar prej 230.000 eurove, informoi sot zëdhënësi qeveritar, Mile Boshnjakovski. Ankandi, siç sqaroi, do të bëhet përmes rrugës elektronike. Lidhur me lëvizjen e mysafirëve të lartë që vijnë në Maqedoni, Boshnjakovski tha se kjo do të sigurohet si edhe deri tani, me standardet më të larta të sigurisë dhe se nuk do të ketë kurrfarë dallimi pas shitjes së "mercedesit". Automjeti u furnizua në kohën e qeverisë së VMRO-DPMNE-së, dhe siç u publikua në "bombat", për të janë paguar rreth 600 mijë euro. Për furnizimin e "mercedesit", PSP ka hapur lëndë "tank", për të cilën po zhvillohet procedurë para Gjykatës penale. Janë akuzuar ish kryeministri Nikolla Gruevski, ish ministrja e Punëve të Brendshme Gordana Jankullovska dhe ish ndihmës ministri në MPB, Gjoko Popovski.



me me trupin gjykues. Kësaj radhe, ai i apeloj gjykatësit Goran Boshevski të punoj sipas Ligjit dhe të mos ndikohet nga presioni politik, respektivisht Gruevski kërkoi "trajtim të njëjtë siç ka kryeministri, Zoran Zaev". Seanca e radhës për rastin "Trajektorja", është caktuar të mbahet në fillim të muajit të ardhshëm, gjegjësisht më datë 1 mars.

Në seancën e dytë për rastin "Trajektorja", përveç ish kryeministrit, Gruevski, në Gjykatë u paraqitën edhe tre të akuzuarit tjerë,

ish Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakievski, ish zëvendës kryeministri për çështje ekonomike, Vlladimir Peshevski dhe ish drejtori i NP për Rrugë Shtetërore, Lupço Georgievski. Vepra penale për të cilën hetohen tre të akuzuarit e fundit lidhet me keqpërdorim të detyrës zyrtare, gjegjësisht për dëmtim të buxhetit në vlerë prej mbi 150 milionë euro. Nga ana tjetër, ish-kryeministri Gruevski akuzohet për praninë të dhuratës për ndikim të kundërligjshëm.

AQ SHPESH JAM NË GJYKATË SA QË FILLOJ TË NDJEJ SIKUR VIJ NË PUNË

Aq shpesh më thërrasin në gjykatë sa që filloj të ndihem sikur vij në punë dhe të kërkoj zyrë dhe rrogë, deklaroi ish-kryeministri dhe ish-kryetar i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, pas seancës së sotme për rastin "Trajektorja". Gruevski theksoi se ka ardhur në gjykatë për diçka, për çka është akuzuar, që është njëjtë si në rastin "Tanku". "Aktakuza ndaj meje është se i kam nxitur bashkëpunëtorët e mi të furnizohen me automjet të blinduar, ndërsa në rastin e dytë të ndërtohen rrugë. Unë e kam bërë atë me qëllim që të shpërblehem, por jo shpërblim në të holla apo shpërblim financiar,



por në rastin me Mercedesin çmimi është se kam hipur në automjet që të shkoj diku, ndërsa në rastin me rrugët kam marrë pikë politike", deklaroi Gruevski. Theksoi se nga të gjitha gjykimet tani për tani përshtypja është se nuk ka gjasa për proces të drejtë gjyqësor dhe për drejtësi. "Gjyqësia po shndërrohet në një gijotinë politike klasike dhe po shohim një gjyqësi të robëruar. Po shohim gjykatës të cilët janë në situatë të pakëndshme dhe është bërë presion ndaj tyre. Kur i lexojnë disa nga vendimet e tyre, i lexojnë shpejt, në mënyrë që sa më shpejt të përfundojë turpi", tha Gruevski.

Rriten keqpërdorimet në rrjetet sociale

Tetovë, 14 shkurt - Vitin e kaluar dhe këtë vit në rajonin më të gjerë të Tetovës dhe Gostivarit dukshëm është rritur numri i keqpërdorimit të të dhënave personale, veçanërisht të atyre që kryhen përmes rrjeteve sociale si Facebook dhe Instagram. Në Sektorin për Punë të Brendshme, vitin e kaluar janë paraqitur 21 raste të këtyre keqpërdorimeve, ndërsa këtë vit janë evidentuar tre raste. Sipas policisë, kryesisht bëhet fjalë për keqpërdorim të të dhënave personale dhe fotografive, të cilat më parë janë ndarë me persona të tjerë, e të cilët më pas - kryerësit e këtyre keqpërdorimeve i kanë publikuar ose janë kërcënuar se përderisa nuk paguhen shuma të ndryshme ose nuk plotësohen shërbime dhe kërkesa të tjera, ato fotografi kryesisht me përmbajtje komprometuese do të publikohen në rrjete sociale. Nga policia thonë se viktima më të shpeshta të keqpërdorimeve të kësaj natyre janë femrat, në të shumtën e rasteve vajza të reja, pas çka janë shantazhuar ose në një tjetër mënyrë janë dëmtuar nga kërcënime nga më të ndryshmet që ndërliken me nderin dhe reputacionin. Sektori për Punë të Brendshme edhe njëherë apelon deri tek përdoruesit e rrjeteve sociale që maksimalisht të jenë të kujdesshëm kur vendosin kontakte me persona të panjohur dhe krijojnë miqësi virtuale, për shkak se mundësia që të keqpërdoren dhe të tërhiqen në situata të palakmueshme me pasoja negative për ata personalisht, për familjen dhe më të afërmit. Kjo veçanërisht vlen për të miturit, të cilët më pak kujdesen për pasojat e mundshme, me vërejtjen se keqpërdorimi i të dhënave personale llogaritet vepër penale për të cilën është paraparë gjobë në të holla ose me burg deri në një vit. (U.H)

Promovohen Komisionet ndëretnike komunale

Shkup, 14 shkurt - Përfundimi i marrëdhënieve ndëretnike në institucionet e sistemit të qeverisjes në nivelin lokal, është projekti i radhës të cilin e realizon shoqata jo qeveritare "Vlerat e Përbashkëta". Duke synuar një konsolidim më të thellë të demokracisë në Maqedoni dhe njëkohësisht përshtetimin e procesit të pranimit të saj në BE, kjo shoqatë përmes projektit "Komisionet për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe bashkësitë etnike", synon promovimin e Komisioneve komunale për marrëdhëniet etnike, rritjen e ndikimit të tyre brenda komunave dhe bashkëpunimin apo forcimin e raporteve mes këtij Komisioni dhe qytetarët. Në njoftimin për media, nga kjo organizatë joqeveritare bëjnë të ditur se ky projekt deri nga mesi i muajit mars do t'i përfshijë katër komuna në vendin tonë, gjegjësisht Komunën e Çairit dhe Butelit në Shkup, dhe Komunën e Tetovës dhe atë të Kumanovës. "Gjatë ditës së mërkurë në hapësirat e Komunës së Çairit u realizua takimi me anëtarët e Komisionit për marrëdhënie ndër etnike i cili është themeluar me 6 shkurt të këtij viti. Pjesë e këtij Komisioni pesë anëtarësh, janë përfaqësues nga bashkësia etnike maqedonase, turke, shqiptare, boshnjake dhe rome. Në këtë mbledhje, temë diskutimi ishte realizimi i plotë i projektit tonë dhe vendosja e agjendës për takimet e radhës që pritet të mbahen brenda disa javëve", tha, Razije Jonuzi, kryetare e shoqatës joqeveritare, "Vlerat e Përbashkëta" nga Shkupi. Pas Çairit, takimi i radhës siç kanë informuar nga kjo shoqatë, do të jetë në Komunën e Kumanovës, dhe më pas në atë të Butelit dhe Tetovës. (O.Xh)

POLITIKAT E GABUARA SHËNDETËSORE NË MAQEDONI

PËR ÇDO VIT IKIN 175 MJEKË

Nga gjithsejtë 220 mjekë të diplomuar vitin e kaluar në tre Fakultetet e Mjekësisë, 173 prej tyre kanë ikur jashtë vendit

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 14 shkurt - Rrogat e ulëta, motivim në rënie i mjekëve nga institucionet shëndetësore, kushtet jo të mira për punë në spitalet dhe klinikat shëndetësore shtetërore, janë arsyt kryesore që një numër i madh mjekëve të specializuar, kryesisht mjekë të rinj, i shtyn të ikin jashtë Maqedonisë dhe profesionin e tyre ta ushtrojnë në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore. Kështu tregojnë të dhënat e fundit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë (OMM), sipas të cilave nga gjithsejtë 220 mjekë të diplomuar vitin e kaluar në tre Fakultetet e Mjekësisë, 173 prej tyre kanë ikur jashtë vendit për të ushtuar profesionin. Nga OMM-ja shprehen tepër të brengosur për faktin se nëse institucionet përkatëse dhe Qeveria e Maqedonisë nuk ndërmarrin ndonjë masë konkrete për të mbrojtur mjekët që të mos e lëshojnë Maqedoninë, shumë shpejtë spitalet dhe klinikat do të mbeten pa mjek specialist.

"Nga viti në vit po rritet numri i mjekëve kryesisht i moshës së re të cilët pasi mbarojnë fakultetin e mjekësisë e lëshojnë vendin dhe largohen për punë jashtë shtetit. Nëse kjo gjendje nuk gjen përmirësim dhe shteti vazhdon të mos respektojë dhe mbrojtë mjekët e rinj, pas tre vitesh Maqedonia do të përballlet me mungesë të theksuar të kuadrit mjekësor", thonë nga OMM. Nuk është vetëm aspekti financiar i cili i shtyn mjekët e rinj të ikin nga Maqedonia, por edhe zhgënjimi i tyre nga autoritetet shëndetësore që aspak nuk respektojnë punën e mjekëve.

"Është më se e vërtetë se arsyeja kryesore që i shtyn mjekët të ikin në vendet e Evropës Perëndimore janë rrogat drastike më të mëdha, kushtet më të mira për punë dhe jetë, si dhe avancimi në profesion. Ky trend i ikjes së mjekëve për shkaqe ekzistenciale në shikim të parë shihet si një proces pozitiv, sepse vendet ekonomike të zhvilluara në Evropën Perëndimore ju ofrojnë kushte më të

mira për kualifikimin e kuadrove shëndetësore, por në anën tjetër sistemi shëndetësor në Maqedoni në të ardhmen edhe më shumë do të ballafaqohet me mungesë serioze të specialistëve", thonë nga OMM-ja.

Si arsye tjetër që mjekët e rinj marrin vendime të ikin jashtë, menjëherë pasi diplomojnë në fakultetet e mjekësisë, janë edhe mos subvencionimi i tyre për të kryer specializime në ndonjë vend të Evropës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Shumica e tyre me vetëfinancim e lëshojnë Maqedoninë dhe vazhdojnë specializimet jashtë vendit. Pas kryerjes së specializimit numër më i madh i këtyre mjekëve nuk kthehen më në Maqedoni.

"Presim një largim të madh të potencialit mjekësor, dhe sidomos të rinjve. Deri në vitin 2020, ka shumë mjekë të cilët do ta përfundojnë karrierën e tyre dhe ne nuk kemi as për së afërmi kuadër për ti zëvendësuar ata, si dhe as në horizont nuk duken kuadro të reja që ti zëvendësojnë kuadrot vjetra që tre vitet e ardhshme shkojnë në pension. Maqedonia ka gjasa të mbetet pa mjekë specialistë. Për dy vjet, më shumë se dy mijë mjekë specialistë do të dalin në pension, por nuk do të ketë kush t'i zëvendësoj, sepse specialistët e rinj, për shkak të pagave të ulëta, po ikin jashtë vendit. Ata që mbeten janë të paktë, dhe aq më i vogël është numri i atyre që mund ti zëvendësojnë", thonë nga Oda e Mjekëve të Maqedonisë.

Edhe nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë në Shkup për gazetën "Koha"

thonë se fajin për ikjen e mjekëve të rinj jashtë vendit e kanë politikat e gabuara që udhëhiqeshin gati pesë vitet e fundit. "Profesioni si mjek është shumë i nënçmuar nga ana e shtetit sa numri më i madh i mjekëve të rinj si dhe kuadri profesional nuk duan të punojnë në sistemin shëndetësor në Maqedoni. Arsyet tani më janë të njohura, politikat shëndetësore të pushtetit të deritanishëm solli që një numër i madh i tyre të mos pajtohen të punojnë në Maqedoni. Rrogat e ulëta kushtet në të cilat po punojnë mjekët në Maqedoni nuk ekzistojnë as në Ballkan apo vend tjetër. Arsyet ekonomike luajnë rol kyç që i shtyn mjekët e rinj të ikin jashtë Maqedonisë", thotë Stevo Panev nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë në Shkup. Sipas tij në klinikat e të gjithë vendit aktualisht punojnë rreth 700 specializantë aktiv. Por, dy të tretat e tyre nuk marrin asnjë pagë. "Shteti po i demotivon jo vetëm mjekët e rinj, por edhe ta të cilët kanë përvojë të gjatë si mjek që të qëndrojnë në Maqedoni dhe shpëtimin e kërkojnë jashtë vendit. Dëmi që pëson sistemi shëndetësor me ikjen e kudarit profesional shëndetësor, është i madh, ndërsa çmimin do e paguajnë qytetarët", thotë Stevo Panev. Ndryshe sipas të dhënave nga Oda e Mjekëve të Maqedonisë, vitin e kaluar 170 mjekë specialistë kanë marrë vërtetime për punë jashtë shtetit, kurse në tre vitet e fundit janë larguar 513 sish. Nga viti 2013, deri tani, 810 mjekë specialistë kanë marrë vërtetimin për punë jashtë shtetit. Në nivel vjetor, ky numër rritet nga 140 deri 172 mjekë specialistë.

IKIN EDHE INFERMIERËT

Nuk janë vetëm mjekët e diplomuar që ikin nga Maqedoni, por viteve të fundit në masë të madhe po ikin edhe infermierët. Nga Shoqata e Infermierëve të Maqedonisë, thonë se ka disa arsye se pse personeli mjekësor apo infermierët nuk duan të punojnë në spitalet dhe klinikat shtetërore. "Shumë nga infermieret, të cilat kanë mbaruar shkollimin e mesëm profesional, përcaktohen për profesione të cilat paguhen më mirë dhe ku mund të krijojnë karrierë akademike. Asnjë infermiere nuk dëshiron të punoj në institucionet shtetërore ku me vite punojnë si vullnetare dhe gjatë kësaj kohe nuk paguhen apo kur atyre u ofrohet vendi i punës shumica prej tyre nuk e pranojnë ofertën për rrogë prej 12.000 denarëve në muaj. Pësha e punës dhe puna me ndërrime është gjithashtu një nga arsytet për mungesën e infermiereve tek ne, nëse merret parasysh fakti se shumica nga të punësuarit janë gra, të cilat kanë rol kyç në familje. Me liberalizimin e vizave, shumë infermiere nga Maqedonia vendosën karrierën e tyre profesionale ta vazhdojnë në vendet e zhvilluara evropiane, ku gjithsesi motiv janë të ardhurat mujore, por dhe zhvillimi i karrierës dhe mundësia për përvetësim më të lartë të arsimit në magistraturë apo doktor në infermiere", thonë nga Shoqata e Infermiereve të Maqedonisë.

MINISTRI BEKT SHI PRITI MINISTRIN KOSOVAR TË INOVACIONIT DHE SIPËRMARRJES

BEQAJ KËRKON AUTOSTRADËN DERI NË BLLACË

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 shkurt - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ka pritur të mërkurën ministrin e Inovacionit dhe Sipërmarrjes të Republikës së Kosovës, Besim Beqaj. Në takim, dy ministrat diskutuan rreth bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, bashkëpunimit tregtar dhe investues, si dhe prezantuan ide dhe propozime që do të kontribuonin në forcimin e bashkëpunimit ekonomik, në të mirën e komunitetit të biznesit nga të dy vendet. "Kolegut Beqaj, i cili kryeson resorin e inovacionit dhe sipërmarrjes, i prezantova masat e planit për rritje ekonomike të qeverisë sonë, e cila përcakton prioritetet kryesore të politikave për periudhën e ardhshme dhe që pritet të rrisin investimet private, krijimin e vendeve të punës, rritjen e efikasitetit, produktivitetit dhe konkurrencës së sektorit privat, rritjen e eksporteve dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal, si dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Lidhur me bashkëpunimin me Kosovën, me masat e Planit për rritje ekonomike presim efekt sidomos në fushën e investi-



Beqaj i përkujton Shkupit ndërtimin e autostradës deri në Bllacë, pasi siç është shprehur ai, do të kontribuojë në rritjen e shkëmbimit tregtar dhe të qarkullimit të njerëzve

meve dhe të bashkëpunimit rajonal që do të jetë i dobishëm për të dy vendet", tha ministri Bekteshi pas takimit. Lidhur me çështjet e interesit të ndërsjellë për dy vendet, Bekteshi informoi homologun e tij kosovar për projektin për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, për të cilën në seancën e fundit të Qeverisë u prezantua dhe u miratua Plani i aksionit me kohëzgjatje për realizim dhe sipas parashikimeve aktivitetet e këtij seksioni 12-kilometërsh do të fillojnë në vitin 2019 dhe të finalizohen deri në fund të vitit 2022. Bekteshi shtoi se shkëmbimi tregtar me Kosovën, u rrit me 11.4 % vitin e kaluar dhe këtë vit është 6% më i lartë, kraha-

suar me vitin 2016. Ministri i Inovacionit dhe Sipërmarrjes i Republikës së Kosovës, Besim Beqaj tha se marrëdhëniet ekonomike me Maqedoninë janë të shkëlqyeshme dhe përshëndeti vendosmërinë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për të përcaktuar kohëzgjatjen e ndërtimit të autostradës Shkup-Bllacë. Sipas tij, ndërtimi i autostradës nga Prishtina në Bllacë nga ana e Kosovës, dhe nga Bllaca në Shkup nga ana e Ma-

qedonisë, do të kontribuojë në rritjen e shkëmbimit tregtar dhe të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve. "Kosova dhe Maqedonia janë dy ekonomi të vogla dhe me një bashkëpunim të ngushtë midis institucioneve dhe midis komuniteteve të biznesit, ata mund të konkurrojnë në tregun botëror, i cili është duke ndryshuar dhe shkon drejt digjitalizimit të plotë. Për këto arsye, Qeveria e Republikës së Kosovës ka theme-

luar Ministrinë e Inovacionit dhe Sipërmarrjes, me qëllim që t'u sigurojë të rinjve kushte të favorshme për drejtimin e bizneseve me mentalitet të ri ekonomik sipas tendencave botërore, të ndryshme nga sistemi klasik për menaxhimin e ekonomisë", tha Beqaj. Në fushën e aktiviteteve të përbashkëta, Maqedonia dhe Kosova pritet të mbajnë seancën e katërt të Komitetit të Përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik në tremujorin e parë të këtij viti, ndërsa në procedurë e sipër është Memorandumi i Bashkëpunimit për Kontrollin e Mallrave Strategjike, i cili pas finalizimit nga dy palët, do të nënshkruhen nga ministrat resorë.

DEBAT PËR FURNIZIMET PUBLIKE

Ligji i ri që mbron nga korrupsioni



Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, potencoi se qëllimi i ligjit të ri është ta përforsojë transparencën

zuar të pragut të tyre nga 500 eurot e tanishme në 1000 euro në sektorin klasik dhe në 2.000 euro në veprimtaritë e sektoreve. "I zgjidhim problemet e shumë shkollave dhe kopshteve sepse ka deficit të kuadrut që punon në furnizime publike dhe gjithashtu me rritjen e pragut të furnizimeve publike ne ende jemi nën të gjitha shtetet e rajonit, do të thotë nuk janë rritur dukshëm në mënyrë që të kemi frikë nga korrupsioni i madh", sqaroi Georgievski. Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, potencoi se qëllimi i ligjit të ri është ta përforsojë transparencën dhe kontrollin e procedurave, ndërkaq në të njëjtën kohë t'i bëjë më të thjeshta dhe më të lehta për zbatim. Me të, siç potencoi, vendoset obligimi i detyrueshëm për publikim të kontratave dhe dokumentacionit tjetër nga çdo furnizim i thjeshtë publik i Sistemit elektronik për furnizime publike. (F.P)

Shkup, 14 shkurt - Furnizimet publike duhet të jenë tërheqëse për shfrytëzuesit, me procedura efikase dhe të thjeshta, e jo ngarkesë plotësuese në punë, porositën pjesëmarrësit e debatit të parë publik për propozim-ligjin e ri për furnizime publike. Sipas drejtorit të Byrosë për furnizime publike, Gjorgji Georgievski, zgjidhja e re ligjore e cila duhet të definohet pas vërejtjeve nga komuniteti afarist, do të sigurojë mbrojtje nga korrupsioni dhe kontroll në bazë të së cilës do të konstatohet përgjegjësia. Në bashkëpunim me Bankën botërore po zbatohet projekt për flamuj të kuq të cilët do të sendërtohen në sistemin e ri elektronik për furnizime publike dhe do të jenë tregues të

korruptsionit. Në ligj vendoset edhe kontrolli paraprak të cilin do ta bëjë Byroja për furnizime publike. Me të do të përfshihen furnizimet më të mëdha publike, si dhe furnizime të zgjedhura sipas parimeve dhe rreziqeve të caktuara. "Kontrolli i furnizimeve do të bëhet në mënyrë sistematike dhe kjo do të zgjidhet mirë. Sistemi do të caktojë së bashku me treguesit për flamuj të kuq apo në çdo të pestin apo të dhjetin konkurs", deklaroi Georgievski. Ligji parashihet të vendoset treg elektronik i furnizimeve të vogla publike, në lloj të katalogut elektronik, që do të mundësojë zgjidhjen e tyre të shpejtë dhe efikase. Ato furnizime duhet të lehtësohen me ngritjen e propo-



Anijet do të zhvendosen nga Vardari

Shkup, 14 shkurt - Dislokimi i parapare i anijeve, spërkatësve, shatërvanëve dhe shelgjeve nga Vardari do të bëhet vetëm për shkaqe sigurie, edhe pse estetika e tyre është diskutabile, vlerësoi të mërkurën kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov. Ai theksoi se shtrati i Vardarit është projekt kapital i ndërtuar pas përmbytjeve në Shkup në vitin 1962 me qëllim që të parandalohen përmbytje të ardhshme dhe se në të nuk duhet pasur pengesa. "Me këtë projekt është parapare shtrati të mund të absorbojë 100 ujëra në vit dhe është ndërtuar në tri nivele. Çdo zvogëlim i shtratit është rrezik prej vërshimeve, ndërsa në asnjë mënyrë nuk guxon të ketë pengesa në shtratin ku janë vendosur anijet. Mu për këtë vendosëm dhe e hoqëm dheun e vendosur para anijes së parë dhe i thamë zbatuesit të punimeve "Beton" që ta heq argjinaturën para urës në ndërtim në të cilën duhej të vendosej "rota panoramike", tha Shilegov në takimi-

min e sotëm me gazetarët. Përmes Shkupit, siç tha, kalojnë tre lumenj Vardar, Treska dhe Lepenci, ndërsa vetëm Treska është rregulluar me liqenin Kozjak. "Një studim i UNDP-së tregon se gjatë përmbytjeve me përmasa të vogla në Shkup, nëse del nga shtrati vetëm Vardari, do të ketë dëme prej rreth 50 milionë euro, nëse del Vardari si edhe një prej dy lumenjve të tjerë do të ketë përmbytje të mesme me dëme prej 252 milionë euro, ndërsa nëse dalin të tre lumenjtë do të ketë dëm mbi 500 milionë euro", tha Shilegov. Për momentin, theksoi, po bëhen analizat e nevojshme që të përcaktohet procedura se si të dislokohen anijet dhe çfarë duhet bërë me urën, ndërsa gjatë kësaj pranvere do të dislokohen edhe shelgjet, spërkatësit dhe shatërvanët prej shtratit të Vardarit. Vlerësimet fillestare, shtoi, tregojnë se për zhvendosjen e anijeve do të nevojiten prej katër deri në 4,5 milionë euro.

VAZHDOJNË PROBLEMET NË INFRASTRUKTURË

SANIMI I GROPAVE KUR TË NGROHET KOHA!

Qytetarët ankohen se krahas problemeve me gropat në rrugë-janë duke hasur edhe në puseta të vjedhura apo të dëmtuara përgjatë rrugës Industriale

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 14 shkurt - Qytetarët e Tetovës ankohen se shumë ngadalë janë duke u sanuar problemet në infrastrukturë. Qytetarët më problem kanë me një pjesë të parregulluar të trotuarit Ilirija, dhe sanimin e gropave nëpër disa rrugë të qytetit të Tetovës. Ata theksojnë se krahas këtyre problemeve-janë duke hasur edhe në puseta të vjedhura apo të dëmtuara përgjatë rrugës Industriale. Këto janë disa nga problemet me të cilët qytetarët e Tetovës janë duke u përballur në këtë periudhë. "Në rrugën Industriale, kohëve të fundit janë duke u vjedhur dhe dëmtuar pusetat dhe kemi shumë probleme gjatë lëvizjes, sidomos gjatë orëve të natës, sepse rrezikojmë të biem në gropë. Poashtu, kjo është rrezik edhe për fëmijët kur kthehen nga shkolla, sepse ata janë të vegjël dhe nuk dinë të mbrohen, prandaj duhet që urgjentisht të vendosen puseta të reja në trotuarin që është afër rrugës Industriale", thotë Bujari, një banor i kësaj lagje. Më tej, problem në vete janë edhe gropat edhe në shumë rrugë të Tetovës,



ndërsa nuk mungojnë edhe gropat në rrugët që para pak kohe janë asfaltuar. Qytetarët janë të irrituar se pse kjo ndodh pikërisht në rrugët që janë asfaltuar gjatë verës së shkuar. "Në këtë rrugë që është nga shkolla e mesme e muzikës e deri tek stadiumi, nuk mund të kalohet pa patur ndonjë gropë. Vetëm javën e parë kemi qarkulluar lirshëm pa probleme, kurse më pas filluar prerjet për të rregulluar gypat e ujësllësit, në disa vende vet është dëmtuar. Kemi shumë probleme dhe kjo nuk është normale, kaq shpesh të kemi probleme me gropat", thotë Bajrami, një vozitës. Në ndërkohë, nga Sektori për Tokë Ndërtimore dhe Komunikacion në Komunën

e Tetovës kanë thënë se është hapur tenderi dhe pritet që muajin e ardhshëm të fillohet me sanimin e gropave. "Janë ndarë mjetet e nevojshme për sanimin e gropave në rrugët e qytetit dhe në rrugët tje-

ra që janë në kompetencë të Komunës së Tetovës. Kur të lejojnë kushtet, do të fillohet me mbushjen e këtyre gropave dhe kjo është në bazë të programës për punë për këtë vit", deklaroi Arsim

Nuredini, udhëheqës i Sektorit për Tokë Ndërtimore dhe Komunikacion në Komunën e Tetovës. Në ndërkohë, problem që gjatë kësaj periudhe është shfaqur është edhe rruga për në Banjat e Tetovës.

Tashmë një kohë të gjatë rruga në këtë pjesë të qytetit vazhdon të jetë e dëmtuar, por edhe e parregulluar, ndërsa krahas rregullimit të rrugës, duhet që urgjentisht të merren masa për ndalimin e erozionit të dheut përgjatë kësaj rrugë. Sipas vozitësve, kjo dukuri nuk është e panjohur në qytetin e Tetovës pasi që shpeshherë gropat që duhet të sanohen - me ditë të tëra qëndrojnë të prera dhe mbullohen me asfalt me shumë vonesë. Qytetarët apelojnë që komuna duhet në kohë dhe në mënyrë të rregullt të kontrollojë problemet në infrastrukturë, sidomos në hapësirat publike që të vërtetojnë dëmtimet dhe në kohë të sanohen.

PATROHEN RRUGËT E MALËSISË SË SHARRIT

Ndërmarrja Publike Komunale dhe firma e angazhuar për pastrim të rrugëve, pas alarmit të banorëve të fshatrave të larta malore të Sharrit për bllokimin e disa rrugëve nga bora, të mërkurën në mëngjes me ritëm të përshpejtuar i pastruan rrugët dhe rrugicat deri në fshatrat malorë, Shipkovicë, Brodec, Veshallë dhe Bozovcë. Rrugët deri te fshatrat janë të pastra, por në disa vendeve janë vështirë të kalueshme për shkak të borës së grumbulluar dhe paraqitjes së ngricës. Nga Komuna e Tetovës deklaruan se

nga e mërkura, të gjitha rrugët janë të kalueshme, me disa vështirësi të vogla. "Pas reagimeve të banorëve të fshatrave malorë dhe menjëherë reaguam dhe i pastruam të gjitha rrugët deri te fshatrat e Sharrit dhe gjithashtu edhe rrugët nëpër Tetovë, Poroj dhe Reçicë. Sot edhe në dy ditët e ardhshme do të fillojmë me pastrimin e rrugëve dytësore, ndërsa gjithashtu do të hedhim edhe kripë që të mos paraqiten ngrica", deklaroi zëdhënësi i Komunës së Tetovës, Armend Fazliu.

PAS NDIHMAVE, BRAKTIS TROTUARIN KU KËRKONTE LËMOSHË



RIKTHEHET BUZËQESHJA NË FAMILJEN JASHARI

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 14 shkurt - Rikthehet drita dhe buzëqeshja në familjen Jashari në Tetovë. Pas apelit të kryefamiljares Nuriye Jashari për ndihmë, e cila është nënë e katër fëmijëve të mitur dhe jetonte në kushte shumë të vështira, pa drunj për ngrohje,

pa ushqime të mjaftueshme, pa rrymë elektrike, me njërën prej vajzave të sëmura, ndihmat në shtëpinë e tyre kanë arritur nga të gjitha anët. Njerëz bamirës i kanë ardhur në ndihmë kësaj familje, kurse ata tanimë nuk jetojnë nëpër terr, kanë drunj për ngrohje, kanë edhe ushqime që do të ju mjaftojnë për një

Për shërimin e vajzës së zonjës Nuriye është përkujdesur një qytetar "anonim" dhe shoqata humanitare "Ndihmo edhe ti"

periudhë. Për shërimin e vajzës së zonjës Nuriye është përkujdesur një qytetar që dëshiron të ngelet anonim dhe i cili ka paguar për 15 ditë qëndrimin e vajzës 4-vjeçare në banjat e Katllanovës, ndërsa 15 ditë të tjera janë paguar nga shoqata humanitare "Ndihmo edhe ti", prandaj gjatë ditës së sotme zonja Nuriye së bashku me vajzën e saj të sëmure janë nisur për në banjat e Katllanovës ku do të qëndrojnë për 30 ditë, ashtu siç i kanë rekomanduar mjekët. Me këtë, asaj i është rikthyer shpresa se vajza do të mund të ngritet në këmbë, i është kthyer edhe gëzimi falë njerëzve bamirës, të cilët i kanë shtrirë dorën për të ndihmuar këtë familje, kurse sadopak kanë kontribuar në zbutjen e skamjes të familjes së saj, andaj ajo edhe njëherë publikisht ka falënderuar nga zemra të gjithë ata që e kanë ndihmuar dhe i janë gjetur pranë në momente të vështira. "Falënderoj të gjithë ata që na ndihmuar në moment të vështira, ofruan ushqime, para dhe veçmas na ndihmuar që të dërgojmë vajzën në Katllanovë dhe shpresojmë se do të

bëhet më mirë vajza. Unë tash me këto ndihma që i kam nuk do të jem më në rrugë për të kërkuar lëmoshë", tha shkurt Nuriye Jashari. Përndryshe apeli për ndihmë që zonja Nuriye ditë më parë bëri sensibilizoi njerëzit human, bamirësit, shoqatat humanitare të cilët menjëherë i erdhën në ndihmë me çka edhe një herë dëshmuar humanizmit e tyre. Nuriye Jashari, nënë e katër fëmijëve tashmë ka braktisur edhe trotuarin ku kërkonte lëmoshë çdo ditë në qytetin e Tetovës për të siguruar një kafshatë buke për familjen. Ditë më parë, nëna Nuriya së bashku me fëmijët e saj të mitur të moshës prej 2 deri në 7 vjeçare kërkoi ndihmë për shkak se jetonin pa kushtet elementare për një jetë normale. Ata më shumë se një vit kanë jetuar pa rrymë elektrike, pa drunj për ngrohje dhe pa ushqim të mjaftueshëm. Ata kanë arritur që të mbijetojnë pa të ardhura, vetëm me ato pak para që ajo grumbullonte gjatë ditës së bashku me vajzën e saj 6-vjeçaren Samijen, duke bredhur rrugëve të Tetovës për të kërkuar lëmoshë nga njerëzit human.

Nuk ka shkëmbim paqësor terriroresh. Mos luani me zjarr!



Nga
Milazim Krasniqi



Çfarëdo initiative për shkëmbin terriroresh me Serbinë është akt tradhtie ndaj shtetit të Kosovës. Ja pse!

Iniciativa e tillë e bllokton përfundimisht njohjen e Kosovës si shtet nga OKB, BE, OSBE dhe NATO-ja, sepse nuk kanë pse ta njohin një shtet që ka dalë në pazar. Më e pritshme do të ishte tërheqja edhe e njohjeve të deritashme.

Iniciativa e tillë minon tërësisht integrimin e serbëve në shtetin e Kosovës. Përderi sa ata në veri do të fitonin atë që duan, bashkimin me Serbinë, serbët në brendësi, do të rebeloheshin dhe do të krijonin milicite e veta, si në Siri. KFOR-i do të mund të tërhiqej, për të mos u përfshirë në një konflikt të brendshëm.

Edhe shqiptarët e pakënaqur do të rebeloheshin dhe do të krijonin milicite e veta. Nuk duhet të harrohet se Kosova është një shtet që nuk ka fare ushtri.

Rusia do të shfaqej pashmangshëm si aktor në krizën e tillë, siç u shfaq në Siri. Me shkëmbim terriroresh, Rusia zbrit në Urën e Ibrit. E pra, nuk është zor të parashihet se çfarë shteti të Kosovës mund të kesh, me Rusinë në Urën e Ibrit!

BE do të lante duart si Pontie Pilati, e kënaqur që "zgjidhjen përfundimtare" me shqiptarët muslimanë do ta bënte Rusia. Kjo ka qenë në ëndërr e vjetër e saj, prej të cilës nuk ka hqur dorë kurrë plotësisht. Ëndërrën ia prishi SHBA në vitin 1999.

SHBA e Trampit i ka duart të lidhura, me dyshimet ndaj presidentit për lidhje me Rusinë. Ndërsa, nëse ato lidhje dalin të vërteta, atëherë situata jonë do të ishte edhe më e tmerrshme, sepse në atë rast Kosova do të mund të bëhej pjesë e pazareve gjeopolitike.

Po edhe pa këto dyshime, duhet ta dijë secili që Rusia me Putinin e vitit 2018 nuk është si

Rusia me Jelcinin në vitin 1999 dhe as SHBA me Trampin nuk është si SHBA me Klintonin në vitin 1999. Kjo do të thotë se sponsori i çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës ka probleme serioze, për ç'arsye asnjë aventurë nuk lejohet.

Edi Rama është manipulanti i tmerrshëm dhe i gatshëm që të ndihmojë Vuçiqin, qoftë dhe në dëm të Kosovës, siç ka bërë disa herë deri sot. Pra, nuk mund të

llogaritet aspak ndihma e Shqipërisë së Edi Ramës për asgjë.

Prandaj, mesazhi është: mos luani me zjarr, mos luani me fatin tonë, mos e shkatërroni ëndërrën tonë që ta kemi shtetin tonë! Nëse e bëni, gjendja do t'u dalë jashtë kontrollit dhe do të zbatohet skenari sirian, me Rusinë në rolin e arbitrit kryesor, bash siç po ndodhë në Siri. Veç mos thoni se nuk e keni ditur!

SHBA e Trampit i ka duart të lidhura, me dyshimet ndaj presidentit për lidhje me Rusinë. Ndërsa, nëse ato lidhje dalin të vërteta, atëherë situata jonë do të ishte edhe më e tmerrshme, sepse në atë rast Kosova do të mund të bëhej pjesë e pazareve gjeopolitike. Po edhe pa këto dyshime, duhet ta dijë secili që Rusia me Putinin e vitit 2018 nuk është si Rusia me Jelcinin në vitin 1999 dhe as SHBA me Trampin nuk është si SHBA me Klintonin në vitin 1999



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Coce Delleçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 14 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Pluralizmi fetar dhe toleranca

Nga
Nikë Gashaj



Njeriu bashkëkohor sot është i ballafaquar me universalizëm religjioz. Para së gjithash, ai është arti sakral në kuptim të gjerë të fjalës i cili është paratempull i traditave të llojllojshme religjioze nga Prendimi deri në Lindje. Është e pamundur për ta mohuar bukurinë arkitektoriale pagëzimtare (Babtisterij) në Pizi, xhamitë e mëdha Qayrevante në Tunis, falëtoret hindiane ose tempujt e Kyotos.

Nëpërmjet të formave të shumta të artit sakral religjionet e ndryshme kanë hyrë në jetën e përditshme të njeriut bashkëkohor. Ata të cilët dikur kanë lexuar vetëm veprat e Toma Akvinskut, ose të Bonaventurës, nuk mund më të jenë indiferent ndaj mësimave religjioze të popujëve tjerë. Sot, për shembull, në Paris, Londër dhe në Hajdelberg, krahas Paskalit, Cetës, Holderlinës dhe Rembrantës, zbulohen shenjtë metafizikë mahnitës të kulturës islame.

Sot të gjitha religjionet e mëdha predikojnë dhe synojnë për vlera të ngajshme dhe orvaten të arrijnë paqën dhe të mundësojnë bashkëjetesën. Përfaqësuesit e besimeve më të rëndësishme dakordohen se toleranca reciproke është domosdoshmëri historike.

Në lidhje me atë, është i njohur parimi kristian sipas të cilit do të mund të rregullohen të gjitha marrëdhëniet në mes të njerëzëve: "Gjithë çka dëshironi për tua bë njerëzit juve, bëni edhe ju atyre". Ose në version të ndalimit: "Mos ia bëni tjetrit ata çka nuk dëshiron me ta bë ty tjetëri". Ndërsa sipas Kuranit: "Njerëzit duhet me i puth të afërmit, sikurse vet vetin", për ta plotësuar edhe atë "Jepja çdo kujtë ata çka jeni të detyruar..."

Më tutje, Bibla thotë se të bekuarit do të jenë paqesjellës ose pacifikues. Sipas disa historianëve të religjionit, vet fjala "islam" rrjellë nga fjala "salam" e cila do të thotë, paq, ndërsa vetëm atëherë i "dorëzohet" fesë, dhe ashtu domethënia e vërtetë e asaj fjalë është "paqa e përsosur", e cila arrihet duke iu dorëzua Zotit.

Në kërkim të modeleve të përbashkëta

Njohjet sociologjike mësojnë: "Respektoje fqinjë e vet nëse dëshiron me qenë i respektuar". Ose, sikurse bukur e thotë, Mark Milani: "Trimëri është me e mbrojtur vetin prej tjetrit, por është burrëri me e mbrojtë tjetrin prej vetit".

Natyrisht, se deri te idetë e mëdha dhe të urta, bujare, fisnike e kultivuese nuk është lehtë as për të ardhur, mirëpo në çdo rast është dhe më vështirë për ti zbatua. Për ti realizua



është i nevojshëm vullneti i mirë, përcaktimi moral, qendrueshmëria dhe dija. Prandaj për respektimin e parimeve me vlerë janë të nevojshme shumë gjera, kurse në anën tjetër janë tepër shumë sfida me të cilat njerëzit dhe bashkësitë fetare ballafaqohen në praktikë e të cilat i largojnë ato nga parimet. Nga historia është e njohur se besimet, edhe përkundrazi mësimi për paq, për puthjen e të afërmeve të vet, të kërkuarit ndjesë, kanë qenë dhe në një masë kanë mbetur, burime të mundshme dhe shkaqe të konfliktit, të shfarosjes së njerëzëve të besimeve të ndryshme. Për atë dëshmojnë dhe luftatë e mëdha fetare në Europë në shekullin 16 dhe 17, të cilat kanë përfundua me kontrata të paqës. Po ashtu dhe postkomunizmi ka sjellë shumë tensione, acarime, përlëshje dhe konflikte ndërnacionale me elemente të forta fetare.

Ka bashkësi fetare e cila shpeshherë nuk i ndjek mësimet e veta teologjike por më tepër sjellet si organizatë politike. Çka duhet të thuhet për ata përfaqësues të bashkësisë fetare të cilët i shkelin parimet e Urdhërit të fesë duke hapur intolerancë dhe urrejtje ndaj atyre që i përkasin një konfesionit tjetër? Sipas logjikës së religjionit monoteist e vetmja e vërtetë është e tij, prandaj sipas tij nuk ka vend për pjesëtarë të religjioneve të tjera. Nga ajo rrjedhë ideja se të tjerët nuk kanë të drejtë ekzistence. Mirëpo, çdo njëanësi apo ekstremizëm fetar mund të jetë i dëmshëm, madje dhe teje i rrezikshëm për marrëdhënie interreligjioze dhe ndërnjerëzore.

Në shtetet në të cilat ekzistojnë

grupe të mëdha të popullsisë e të cilat dallohen sipas përkatësisë nacionale, etnike, gjuhësore, konfesionale, etj. është shumë me rëndësi të kërkohen, të gjinden e të miratohen modelet më të mira, të drejta të përshatshme, reale, adekuate, shoqërore, politike, kushtetuese e ligjore për një jetë të përbashkët dhe të barabartë të të gjithë gjytetarëve. Pra ka të bëjë me realizimin konsekuet të të drejtave individuale dhe kolektive të qytetarëve. Bashkësitë fetare, respektivisht kishat dhe eprorët e tyre në atë drejtim mund të kenë një rol me rëndësi.

Multikulturalizmit si parim hyjnor Vetëdija për ekzistencën e multikulturalizmit sotë është bë universale. Do të duhej dhe më tutje të kultivohet, në veçanti dialogu ndër fetar dhe toleranca. Ajo nuk është vetëm fryt apo fitore qytetëruese e botës bashkëkohore, e cila është ngritur në themelet e humanizmit europian, por ajo është dhe parim hyjnor i cili qendron në themelet e botës.

Sipas njohjeve teologjike, në Kosmos është gjithë çka në shenjë të dialogut dhe tolerancës, ndërsa është detyrë e besimtarëve që atë parim ta respektojnë dhe fisnikërojnë. Nga një fakt i tillë varet dhe cilësia e marrëdhënieve ndërnjerëzore në një shoqëri, respektivisht në atë dhe qendron edhe përgjegjësia më e madhe e njeriut. Në atë kontekst, teologu dhe filozofi i njohur Hans Kung ka theksuar se dialogu në mes religjioneve në shekullin 21. ka një rol vendimtar për fatin e botës bashkëkohore. Autori në fjalë, këtë e ka thënë, meqenë se disa studiues kanë shprehur frikë se

Bota bashkëkohore jeton në pluralizëm, nacional, etnik, religjioz etj. Pluralizmi religjioz është pasojë e kulturës planetare bashkëkohore. Prandaj, për shembull, në vendet e Europës Perendimore jetojnë me dhjeta milionë muslimanë, ndërsa në vendet islamike –arape qëndron një numër i madh i të krishterëve.



në një të ardhme mund të vin deri te përplasjet e qytetërimeve në botë. Mirëpo, duhet të besojmë se nëpërmjet të dialogut të mirëfilltë, mençurisë e racionalitetit njerëzor, mundësitë e tilla do të çlërohen, shmangen dhe tejkalohen.

Në kohët e fundit pluralizmi religjioz përjeton ndërrime e transformime me rëndësi. Prej izolimit kulturor dhe religjioz bota është drejtua rrugëve të vetëdijes globale ekumenike apo të përgjithshme. Duhet të shpresojmë se religjionet e ndryshme, veçanarisht ato më të rëndësishme, në të ardhmen do ta avansojnë dhe redefinojnë marrëdhëniet e veta ndaj botës bashkëkohore, dhe njëheri dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta. Në atë drejtim fjala dialog nuk duhet të thotë vetëm të folurit, por dhe të dëgjësës së tjetrit, pranimit dhe mirëkuptimit i të tjetrit në specifikat e veçantit e tij, respektivisht në kulturën e tij vetiake.

Pefundim: për një dialog ndërreligjioz duhet më së pari të mënjahen dhe shmangen paragjykimet, devijimet, vlerësimet a gjykimet me hamendje, në mënyrë që të krijohet hapësira për njohjen e të vërtetës. Toleranca interreligjioze nënkupton tejkalimin e fundamentalizmit fetar, për arsye se fundamentalistave nuk u janë të afërta parimet e tolerancës. Përkundrazi, ata mandje dhe e konsiderojnë se ajo mund të shkaktoj konfuzion, çrregullime, kaos dhe dezorientim tek njeriu bashkëkohor. Më në fund mund të konkludohet se fundamentalizmi në esencë është reagim konservativ ndaj sfidave të botës bashkëkohore.

Një rrjet i organizuar nga Giorgio Nissim, një antifashist i mbështetur nga disa arqipeshkë për të shpëtuar përmes letrave jetën nga vdekja. Pas vdekjes së Nissim-it, fëmijët e tij i gjetën në papafingo ditarin e të atit, një dëshmi besnike për kilometrat e përshkruar, rrugët alternative dhe për ndonjë rrezik të papritur, inventar të çdo pasaporte, udhëzimet, rrugët e shpëtimit, të gjitha këto lëviznin përmes një mjeti të padyshimtë, perfekt, ideal, përmes kampionit, idhullit Gino Bartalit, të brohoritur nga ushtarët e Musolinit

Është e zakonshme radha e turistëve në Firenze, qendrën e rilindjes, por para dedikimit të Gino Bartali-it (1914-2000) radha është modeste. Gino ishte një çiklist i njohur me nofkën "Ginettaccio" (fanella elegante) edhe pse jo më i madh se bashkëpatrioti i tij mitik, Fausto Coppi apo rivali i tij francez, Jacques Anquetil dhe përtej 91 fitoreve të tij në gara standarde, tre xhirove në Turin e Italisë, 1936, 37 dhe 47 dhe 2 tureve të tij në "Tours de France", 1938 dhe 1948. Për më të interesuarit muzeu nuk ka ekspozuar foto shumë emocio-nuese: foto familjare, të kurorëzimit, në një qoshe, me biçikletat që ka ngarë, me disa modifikime teknologjike të kohës për dekadat 1935-1954. Tërheqin vëmendjen dy nga nderimet që i janë bërë: tri medalje ari italiane për Meritë Civile dhe diploma "I drejtë mes Kombeve" dhënë nga Izraeli.

NJË ENIGMË... APRIORI, ASGJË TË JASHTËZAKONSHME

Lindi në vitin 18 korrik të 1914 në Ponte a Ema, ku dhe do të kalonte gjithë jetën e tij. I biri i disa fermerëve të varfër, por jo të vobektë, në moshën 13 vjeçare i ati i gjen një punë në një oficinë biçikletash. Pronari, për merita në punën e çirakut, i dhuron një të tillë dhe e inkurajon të stërvitet. Qysh prej asaj kohe bota do të ishte për Gino-n rrugë dhe muret e oficinës.

Dhe ja tek e gjen veten çiklist dhe do të jetë akoma më shumë... Në vitin 1936 ndodh një fatkeqësi: i vëllai Giulio edhe ai i apasionuar pas dyrotakut vdes i shtypur nga një makinë. Gino fillon të fitojë garat lokale dhe martohet me një fqinjën e tij Adriana Bani dhe nga kjo martesë i lindin dy djem, Andrea dhe Luigi. Jeta për Gino-n do të ndryshonte, ishte dritë dhe hije, hija e Benito Musolinit, diktatori patetik dhe ortak i Adolf Hitlerit dhe ferri do të vendosej në tokë. Musolini, ashtu si punëdhënësi i tij vendosi që raca e bardhë ishte

GINO BARTALI



KAMPIONI I ÇIKLIZMIT QË SHPËTOI 800 HEBRENJ

superiore ndaj asaj zezake dhe që në lojërat olimpike të vitit 1936 u turpërua nga një zezak i Alabamës, Jesse Owens - 4 medalje ari-, e vendosi politikën e tij mbi triumfet e Gino-s, i zgjedhur si sportisti emblemi i fashizmit. Por për çiklistin këmbët dhe rrotat janë në simbiozë me njëra-tjetrën, e përçmon politikën dhe e urren Musolinit dhe shpirtin e jep vetëm për shpejtësinë dhe për besimin katolik si dhe për shoqërinë sportive "Aquila", klubi i vendit të tij. Nuk kërkon asgjë. Në vitin 1938 projekti i Hitlerit për shfarosjen e hebrenjve të Evropës mbërrin në bunkerin e Duçes, por drenazhi është i ngadaltë në fillim, cunami mbërrin në vitin 1943.

Gino shikon, Gino mendon. Pa ngritur dyshime dyfishon dhe trefishon stërvitjen e tij. Një të diel para një gare inspektorët kontrollojnë dhe peshojnë biçikletat sipas protokollit dhe Gino i ndërpret: "Kontrolloni, por me kujdes. Çdo

tub i makinës sime është dizenuar shkencërisht, çdo ndryshim mund të më dëmtojë...". Pak kohë pas vdekjes së tij në 5 maj 2000, në moshën 85 vjeçare, i biri do të bënte të ditur enigmën e jetës sportive të të atit duke treguar kështu shpirtin fisnik të mbetur në hije. Në ato vite të tmerrit fashist dhe gjatë garave hipur mbi biçikletë, Gino Bartali shpëtoi 800 hebrenj nga deportimi dhe vdekja e sigurt në kampe naziste. Nga një cep në tjetrin përgjatë rrugëve të Toskanës dhe të Umbrias, nëpër skarpitet malore, fushat e gjera, çdo tub i biçikletës, çdo qoshe e mundshme fshihte dokumente dhe pasaporta, në disa raste false për hebrenjtë e fshehur nëpër manastire dhe abaci.

NJË ANTIFASHIST I MBËSHTETUR NGA DISA ARQIPESHKË

Një rrjet i organizuar nga Giorgio Nissim, një antifashist i mbështetur nga disa arqipeshkë për të shpëtuar përmes letrave jetën nga vdekja. Pas vdekjes së Nissim-it, fëmijët e tij i gjetën në papafingo ditarin e të atit, një dëshmi besnike për kilometrat e përshkruar, rrugët alternative dhe për ndonjë rrezik të papritur, inventar të çdo pasaporte, udhëzimet, rrugët e shpëtimit, të gjitha këto lëviznin përmes një mjeti të padyshimtë, perfekt, ideal, përmes kampionit, idhullit Gino Bartalit, të brohoritur nga ushtarët e Musolinit. Shumë herë e kanë pyetur Andrean, djalin e tij, se si është e mundur që një histori e tillë e jashtëzakonshme, e denjë për kinematografinë u mbajt e fshehur nga Gino për kaq shumë vite dhe që nuk u bë e ditur. Përgjigjja është gjithmonë e njëjtë: "Im atë ishte një katolik i ethshëm. Kurrë ose pothuaj nuk na foli për atë çka ndodhi gjatë luftës. Thoshte vetëm se këto gjëra në jetë thjesht bëhen". Një njeri prej mishi e kockash dhe material

prej heroi. Përballë muzeve të Firences dhe bukurisë së Rilindjes nuk do të ishte keq të ndaleshit në muzeun e Gino Bartalit, të shikonit fotot e këtij njeriu dhe të mbështetshis mbi altarin që mban biçikletën e tij. (bota.al)



Lindi në vitin 18 korrik të 1914 në Ponte a Ema, ku dhe do të kalonte gjithë jetën e tij. I biri i disa fermerëve të varfër, por jo të vobektë, në moshën 13 vjeçare i ati i gjen një punë në një oficinë biçikletash. Pronari, për merita në punën e çirakut, i dhuron një të tillë dhe e inkurajon të stërvitet. Qysh prej asaj kohe bota do të ishte për Gino-n rrugë dhe muret e oficinës



FRIDRIH PAULUS DHE DEFEKTI I USHTRISË GJERMANE NË STALINGRAD

Paulus dhe Stalingrad, kur përmendet emri i njërit të shkon mendja te tjetri. Janë dy emra që do të jenë gjithmonë të lidhur

Fridrih Paulus, emri i komandantit gjerman që me dështimin e tij shkaktoi një nga disfatat më të mëdha në historinë e njerëzimit dhe vetë emri i vendit në Rusi ku zuri vend kjo disfatë. Friedrich Paulus (Fridrih Paulus) lindi në vitin 1890 në Brajtenau, një qytezë e vogël në Hese. Edhe pse të afërm të tij atje kishin qenë njerëz me pozita, babai i tij kishte qenë një nëpunës i thjeshtë publik; arkëtar i një shkollë. Ai trashëgoi shëndet, fizik të mirë dhe një reputacion deri diku fisnik, por prapë se prapë ai ishte një "fon", një parashtesë e fisnikërisë gjermane të implikuar në ushtri, e cila shpesh në mënyrë të gabuar i atribuohet atij. Ai do ta vuante mungesën e statusit të tij social kur ai refuzohet në Shkollën e Kadetëve të Flotës Pe-raandorake. I zhgënjyer ai studioi drejtësi në Universitetin e Marburgut, por shpejt i mbylli studimet kur Ushtria Gjermane po zgjerohej në 1910. Ai hyri në shërbimin ushtarak si një oficer kadet për një njësi provinciale, III Regjimenti Këmbëorisë.

Brenda dy viteve ai mori gradën e lutenantit (togërit) dhe në këtë njohu edhe të shoqen. Fëmija i tyre i parë, një vajzë, lindi në 1914, viti në cilin Paulusi shkon në luftë. Gjatë Luftës së Parë Botërore ai shërbeu si adjutant i stafeve të njësisë ku ai bënte pjesë. Më e rëndësishmja për karrierën e tij ishte kur ai u bë adjutant për Alpenkorps, një formacion i cili përdorej si rezervë për luftimet malore. Formacioni në të cilin mori pjesë Paulusi luftoi në Ballkan dhe në betejën e përgjakshme të Verdunit. Armë pushimi e gjeti Paulusin me



gradën e kapitenit dhe me dekoratat e Kryqit të Hekurit klasi I dhe II. Gjatë kohës në ushtrinë e Reichswehr-it (Ushtria gjermane midis dy luftërave) ai filloi të evidentohet si një oficer që i mungonte vendosmëria, një e metë e cila do të tregohet qartësisht në angazhimin e tij më të madh, e cila përfundoi në katastrofë për Gjermaninë, beteja e Stalingradit.

Por ka bashkëkohës të tij në ushtri që e vlerësojnë për modestinë, maturinë dhe talentin e tij ushtarak. Në vitin 1930 ai filloi të angazhohej në forcat e mekanizuara të cilat ishin në embrionin e tyre dhe në 1934-ën ai drejtoi një nga batalionet e para të mekanizuara dhe më vonë u bë Shef Shtabi në bazat e reja qen-

drore të pancerzve në Berlin. Kur fillon Lufta e Dytë Botërore ai bëhet shef stafi i Ushtrisë së 10 e cila avancoi pa problem në Poloni në 1939. Ky formacion i madh ushtarak, i komanduar si në Poloni dhe tashmë në Francë nga Valter fon Rajhenau, në fushatën e 1940 u emërua Ushtria e 6. Pas suksesit të shpejtë në Francë në shtator ai emërohet si Shef i logjistikës i OKH (Komandës së Lartë të Ushtrisë) dhe në fund të 1940 planifikon Operacion Barbarosa për pushtimin e Rusisë. Kur Hitleri sulmon në Rusi, Ushtria 6 bën pjesë në formacionin e Grupit Ushtarak Jugor, që u mësym në Ukrainë. Në fund të 1942 Rajhenau vdiq dhe zëvendësi i tij Paulusi, u bë komandant i Ushtrisë 6. Plani Barbarosa dështoi në 1941 dhe tashmë Hitleri i ndryshoi planet e tij dhe lëshoi një ofensivë të re verore në vitin 1942 me synim për të shtënë në dorë Kaukazin.

Ushtria 6 nën drejtimin e Paulusit rropatet e patrazuar përgjatë gjithë avancimit të saj drejt qytetit të Stalingradit. Ky ishte një qytet i cili kishte rëndësi për suksesin e operacionit pasi jo vetëm që do të stabilizonte frontin në favor të gjermanëve, dhe do të pushtohej një zonë e madhe indu-

striale duke dëmtuar edhe prodhimin industrial të Bashkimit Sovjetik, por për më tepër marrja e Stalingradit do të përbente një 'shok' psikologjik për popullin rus pasi kjo qendër urbane kishte emrin e liderit të madh sovjetik, Josif Stalin. Beteja e Stalingradit filloi në fund të gushtit 1942. Shumë shpejt Ushtria 6 ngeci në luftimet e ashpra urbane që e karakterizuan këtë betejë që në fazat fillestare. Kur sovjetët kundërsulmuan duke rrethuar Stalingradin me 23 nëntor 1942, Paulusi kërkoi leje që të tërhiqej dhe të godiste avancimin rus, por Hitleri e ndaloi. Rrethimi u mbyll dhe xhepi filloi të eliminohej gradualisht. Paulusi u dorëzua me 31 janar 1943, në të njëjtën ditë kur Hitleri i dha gradën e Feldmarshalit (grada më e lartë ushtarake në ushtrinë gjermane). Hitleri e bëri këtë sepse në këtë mënyrë ai besonte se mund ta detyronte Paulusin që të kryente vetëvrasje dhe të shpëtonte nderin e ushtrisë gjermane. Pasi iu dorëzua rusëve ai qëndroi në internim për 11 vjet, por kurrsesi nuk u trajtua keq. Ai nuk e pa më gruan e tij e cila vdiq në 1949 në Gjermaninë Perëndimore. Paulusi vetë vdiq në një klinikë në Dresden në moshën 67-vjeçare.

Dëshmitarët e Stalingradit



Mes gushtit 1942 dhe shkurtit 1943 forcat gjermane dhe të Ushtrisë së Kuqe luftuan nëpër rrugët e Stalingradit. Luftimet u përqendruan në katet e pallateve, stacionin e trenit, në një departament të madh magazinimi dhe në kodrën Mamajev Kurgan që shikoje në të gjithë qytetin. Fillimisht trupat gjermane kishin avantazhin, por kur Stalini urdhëroi "asnjë hap mbrapa", Ushtria e Kuqe mbrojti qytetin e saj me egërsi.

USHTARI GJERMAN WILLI HOFFMANN, I DIVISIONIT 94 TË KËMBËORISË

13 SHTATOR. Një datë e keqe, batalioni ynë ishte shumë i pafat. Katjushat [raketë hedhësit rusë] shkaktuan humbje të rënda këtë mëngjes: 27 vdiqën dhe 50 u plagosën. Rusët luftuan me dëshpërimin e kafshëve të egra: ata nuk ia lejonin vetes të merreshin të burgosur, por ata të lejojnë që t'u afrosh dhe më pas ata të hedhin granata. Litenant Kraus u vra dje, dhe tani nuk kemi një komandant kompanie.

16 SHTATOR. Batalioni ynë po sulmon ashensorin e uzinës së grurit me tanke. Po del tym prej saj. Gruri po digjet brenda dhe me sa duket rusët ia kanë vendosur vetë zjarrin. Në ashensor nuk ka njerëz, por djaj që as zjarri as plumbi nuk i kap.

USHTARI RUS NIKOLAI MAZNITSA, I DIVISIONIT 95 MBI MBROJTJEN E MAMAJEV KURGANIT

19 SHTATOR. Një sulm filloi në mëngjes dhe zgjati 48 orë. Armiku lëvizte pashmangshmërisht drejt majës në gjashtë njësi. Kishte kohë që për ne ata ishin të pamposhtur. Por gjashtë njësitë nuk e përballuan zjarrin tonë, dhe ne nxituam në sulm... Shumica më e madhe trupave gjermane dukej se ishin të dehur dhe e hodhën veten me furi drejt majës. Pas çdo rreze bombardimi kishte një moment heshtjeje si varri... Por më pas kodra ngjallej sërish si një vullkan dhe ne do të zvarriteshim për tek gropat e predhave dhe do t'i fusnim në punë mitralozat. Cilindrat e armëve ishin të kuq dhe të nxehtë dhe uji ziente brenda tyre. Burrat tanë sulmonin pa dhënë urdhër... Ishte një heroizëm masiv. Ne humbëm shumë burra si rezultat i bombardimeve në gropat e predhave... Shpatet e kodrës ishin të mbushura plotësisht me trupa. Në disa vende ti duhej të lëvizje 2 apo 3 trupa që të shtrihesh poshtë.



SERBIA PO I ARMATOS SERBËT E BOSNJËS



Sipas mediave ndërkombëtare bëhet fjalë për një dërgesë prej 2,500 pushkësh automatike të cilat nga Serbia do të mbërrin në mars, në gjysmën e Bosnjës të drejtuar nga serbët, disa javë përpara hapjes së planifikuar të një qendre të re trajnimit ku këshilltarët rusë pritet të luajnë një rol të rëndësishëm. Siç shkruajnë më tej mediat e huaja, armët po arrijnë në një kohë kur stabiliteti afatgjatë i Bosnjës është në dyshim.

Mediat rikujtojnë faktin se Marrëveshja e paqes e Dejtonit përfundoi konfliktin boshnjak pak më shumë se 22 vjet më parë, duke e ndarë vendin në dy pjesë gjysmë autonome: Republika Srpska (RS) dhe një Federatë myslimano-kroate. Marrëveshja ndaloi vrasjen, por sipas tyre, krijoi një sistem që shpërbleu politikën e bazuar etnikisht

– partitë nacionaliste kanë një kontroll të ngushtë në pushet, korrupsioni është i përhapur dhe vendi ka shkallën më të lartë zyrtare të papunësisë së të rinjve në botë. Ndërkaq, aktivistët e shoqërisë civile serbe, qeveria qendrore e Bosnjës në Sarajevë dhe diplomatët perëndimorë besojnë se një njësi e re policore e armatosur do të përdoret nga kreu separatist serb boshnjak, Milorad Dodik, për të forcuar pozitën e tij dhe për të trembur kundërshtarët përpara zgjedhjeve në tetor. Në afat më të gjatë, ata frikësohen se forca mund të përdoret për të vazhduar synimet e Dodik për pavarësi, me rrezikun e një lufte të re në rajon.

Rusia, e cila e sheh Dodikun si një bastion kundër anëtarësimit të Bosnjës në NATO, ka treguar mbështetje të fortë për se-

paratistin serb, i cili e ka takuar Vladimir Putin të paktën gjashtë herë që nga viti 2014. Të hënën, Dodik konfirmoi blerjen e armëve, e cila u raportua për herë të parë nga mediat në Sarajevë dhe ai tha se do të ndërmerre hapa të mëtejshëm për të armatosur policinë për "luftën kundër terrorizmit". "Është një veprim krejtësisht legjitim dhe nuk kemi asgjë për të fshehur", citohet të ketë thënë Dodik. "Për 20 vjet nuk kishim të drejtën për të pajisur policinë, tani kemi vendosur ta bëjmë atë". Ndërkaq përfaqësuesi i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në Bosnje, Valentin Inzko shprehu shqetësim në lidhje me dërgesën. "Dua që vendi të ketë sa më pak armë të jetë e mundur. Nëse njëra palë merr këto lloj armësh, atëherë pala tjetër do t'i dëshiron të gjithashtu", tha ai.

paratistin serb, i cili e ka takuar Vladimir Putin të paktën gjashtë herë që nga viti 2014.

Të hënën, Dodik konfirmoi blerjen e armëve, e cila u raportua për herë të parë nga mediat në Sarajevë dhe ai tha se do të ndërmerre hapa të mëtejshëm për të armatosur policinë për "luftën kundër terrorizmit".

"Është një veprim krejtësisht legjitim dhe nuk kemi asgjë për të fshehur", citohet të ketë thënë Dodik. "Për 20 vjet nuk kishim të drejtën për të pajisur policinë, tani kemi vendosur ta bëjmë atë".

Ndërkaq përfaqësuesi i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në Bosnje, Valentin Inzko shprehu shqetësim në lidhje me dërgesën. "Dua që vendi të ketë sa më pak armë të jetë e mundur. Nëse njëra palë merr këto lloj armësh, atëherë pala tjetër do t'i dëshiron të gjithashtu", tha ai.



Greqia ka kërkuar largimin e Çamërisë nga librat

Ndërkohë që shqiptarët presin zgjidhje për çështjen Çame, Greqia jo vetëm që nuk pranon bisedimet rreth kësaj çështje por edhe kërkon "pastrimin" e librave shkollor nga kjo çështje. Kjo ka qenë deklarata që është bërë nga ministri i Jashtëm i Greqisë Nikos Kotzias në Parlamentin e shtetit fqinj. Ministri Kotzias është shprehur se pala greke gjatë bisedimeve të komisionit dypalësh të ekspertëve ia ka bërë të qartë palës shqiptare se termat: 'territoret shqiptare në Greqi' dhe emërtimi 'Çamëri' për terriore që janë në shtetin grek duhet të fshihen nga librat shkollorë të Historisë e Gjeografisë. "Gjatë takimit të fundit të Komisionit të Përzier të Ekspertëve Greko-Shqiptar, pala greke ka këmbëngulur në fshirjen nga librat shkollorë të shprehjeve të papranueshme e fyerëse për unitetin e vendit tonë (Greqisë) si: 'territoret shqiptare në Greqi', përcjell albeu. Por edhe shprehjet dhe hartat në të cilat krahina gjeografike greke shfaqen me emërtimin 'Çamëri', të cilat demonstrojnë, fatkeqësisht, se shtetit shqiptar mbetet i bllokuar në retorike anakronike nacionaliste dhe me qëndrime idemadhe, të dëmshme dhe të rrezikshme në radhë të parë për vetë Shqipërinë", thuhet në përgjigjen e Kotzias dërguar parlamentit, sipas mediave greke.

Serbia dërgon tanke në kufi me Kosovën?

Ushtria e Serbisë e ka nisur armatimin e rëndë në kufi me Kosovën në prag të dhjetë vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Portali 'Zëri.info' e ka siguruar një video, ku shihen tanket serbe duke shkuar nga Presheva në drejtim të pikës kufitare në fshatin Muqibabë në kufi me Gjilanin.

As ndarje, as shkëmbim të territoreve me Serbinë

Deputeti i Parlamentit të Serbisë, Millovan Drecun, ka deklaruar se "Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi është duke u përpjekur që 'nën tavolinë' të ofrojë bisedime për mundësinë e shkëmbimeve të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë"



Opozita kosovare po e kundërshton fuqishëm çdo iniciativë të mundshme për ndarje të Kosovës apo për shkëmbim të territoreve me Serbinë. Ditë më parë më media u raportua se presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe lideri i

Bashkimit Demokratik për Integrim në Maqedoni Ali Ahmeti kanë biseduar në Tiranë për ndarjen e Kosovës, përkatësisht për vizatimin e kufijve në Ballkan, shkruan gazeta "Zëri". Por vetë Thaçi gjatë takimit që ka zhvilluar

të hënën me presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor, e ka cilësuar si shqetësues dhe të dëmshëm debatin rreth idesë për ndarjen e Kosovës.

Përfaqësuesit e opozitës në vend vlerësojnë se me Serbinë as

që duhet të diskutohen temat e tilla dhe se me këtë të fundit duhet të diskutohet vetëm për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Në anën tjetër deputeti i Parlamentit të Serbisë, Millovan Drecun, ka deklaruar se "Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi është duke u përpjekur që 'nën tavolinë' të ofrojë bisedime për mundësinë e shkëmbimeve të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë".

Ndërkaq, analistë të çështjeve politike në vend po konsiderojnë se debati për shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë bëhet nga ata që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe se po luhet një "lojë me zjarr", e cila mund të shkaktojë trazira.

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj në një intervistë për

"DW"-në kishte thënë se deklaratat për ndarje territoriale të politikanëve serbë nuk janë serioze dhe lojëra të tilla janë të rrezikshme.

Bartësi kryesor i idesë së ndarjes së Kosovës është Hashim Thaçi, konsideron politikania serbe nga Kosova, Rada Trajković, e cila "nuk mendon" se autoritetet në Beograd "nuk janë në njëfarë marrëveshjeje me Thaçin", dhe pohon se Beograd "është një prej mbështetësve kryesorë" të Thaçit dhe Kadri Veselit, shkruan Koha Ditore.

Në një deklaram për agjencinë FoNet, Trajković ka thënë se "kjo strukturë, e cila është vendosur në Kosovë, është mbajtur direkt pikërisht në marrëveshje me Beogradin dhe Listën Serbe".



Uashingtoni ka bërë thirrje për qetësi dhe zgjidhje diplomatike, duke kërkuar nga të dy palët të respektojnë marrëveshjen e vitit 1996, kur dy vendet u gjenden thuasje në prag lufte. Sipas kësaj marrëveshjeje, Greqia dhe Turqia duhet të largojnë trupat ushtarake nga kjo zonë dhe të mos provokojnë njëra-tjetrën.



KRYEMINISTRAT E GREQISË DHE TURQISË, “PËRLESHJE” TELEFONIKE

Kryeministrat e Greqisë dhe Turqisë, në një moment tepër të tensionuar në marrëdhëniet mes dy vendeve, kanë pasur një bisedë telefonike të kërkuar nga pala turke në mbrëmjen e së martës.

Tsipras i ka thënë homologut të tij Gildirim se zhvillimet e fundit dëmtojnë marrëdhëniet greko-turke, ato euro-turke dhe shkelin të drejtën ndërkombëtare. Gjithashtu, i ka theksuar atij nevojën për t'i dhënë fund menjëherë shkeljeve provokuese në rritje në ujrat territoriale dhe hapësirën ajrore të ishujve grekë në Egje dhe për të ulur tensionin.

Biseda telefonike e dy udhëheqësve është bërë pas një sërë zhvillimesh që pasuan incidentin e orë-

ve të fundit, kur një anije ushtarake turke ka përplasur një anije greke pranë ishullit, Imia të kontestuar nga Turqia.

Në fillim, Athina ka bërë një notë proteste ndaj Ankarasë dhe ka thirrur për shpjegim ambasadorin turk në kryeqytetin grek. Më pas, Ministria e Jashtme turke ka deklaruar se ishulli Imja i përket Turqisë, ndërsa përgjigja e palës greke ka qenë se Ankaraja, përveçse ka humbur logjikën, dëshmon se nuk njeh as gjeografi.

Ndërkohë, Ministria greke e Mbrojtjes, që ndjek me shqetësim situatën, ka shpallur gjendje të lartë gadishmërie të trupave ushtarake, ndërsa ministri Kamenos do të informojë në Samitin e

NATO-s për zhvillimet e fundit. Gjithashtu, të paktën 8 anije ushtarake greke janë çuar përreth ishullit Imja, ku thuhet se ndodhen edhe 11 luftanije turke.

Nga ana e tij, Uashingtoni ka bërë thirrje për qetësi dhe zgjidhje diplomatike, duke kërkuar nga të dy palët të respektojnë marrëveshjen e vitit 1996, kur dy vendet u gjenden thuasje në prag lufte. Sipas kësaj marrëveshjeje, Greqia dhe Turqia duhet të largojnë trupat ushtarake nga kjo zonë dhe të mos provokojnë njëra-tjetrën.

Departamenti amerikan i Shtetit i kërkoi Greqisë dhe Turqisë që të çtensionojnë situatën në detin Egje, pasi një anije e rojes bregdetare turke goditi një anije greke

patrullimi, të hënën në mbrëmje pranë ishujve Imia.

“Prej një kohe të gjatë Turqia dhe Greqia kanë vendosur kanale diplomatike për të shqyrtuar çështjet që lidhen me Egjeun”, tha një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit.

“Ne nxisim palët për të marrë të gjitha masat për çtensionimin e situatës. Si një çështje parimore, SHBA mbështet sovranitetin e vendeve të rajonit, përfshirë Greqinë dhe Turqinë”, theksoi ai.

Gjithashtu, edhe BE-ja ka reaguar me një deklaratë me anë të së cilës i ka kërkuar Ankarasë të respektojë parimet e fqinjësisë së mirë.

Situata mes dy vendeve u ten-

sionua pas dërgimit të fregatës italiane në Zonën Ekskluzive Ekonomike të Qipros, ku anijet turke po pengonin shpimin në det nga SAI-PEM 12000.

Fregata italiane e përfshirë në misionin e NATO-s «Sea Guardian» në Mesdheun Lindor mori udhëzime për të shkuar në rajon dhe shmangur tensionet me anijet turke.

Deklarata të ashpra u bënë edhe nga presidenti turk Erdogan, pas një tjetër incidenti në ishullin Imia ku një fregatë turke përplasi një luftëanije greke.

“Paralajmërojmë ata që janë përtej kufijve në Qipro dhe në Egje që të mos ndër marrin veprime të gabuara”, deklaroi Erdogan.



Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, thotë se rekomandimet e policisë për të ngritur akuza ndaj tij do të përfundojnë pa sukses. Në një fjalim përmes të cilit ai ju drejtua kombit me televizion, Netanyahu i mohoi me forcë pretendimet se kishte pranuar dhurata të tepruara, si shampanjë dhe puro të shtrenjta nga manjati i Hollivudit Arnon Milchan, në këmbim të favoreve. Zoti Netanyahu po ashtu dyshohet se ka trajtuar me preferencë një botues, në këmbim të mbulimit të tij pozitiv në gazetë. Netanyahu tha se karriera e tij

e gjatë politike është fokusuar vetëm tek e mira e vendit. Ai e akuzoi policinë për një gjueti shtrigash kundër tij dhe u zotua se ka për të vazhduar të qëndrojë në pushtet. Ai e mbylli fjalimin e tij në televizion, duke thënë se ka ndërmend të kandidojë përsëri në zgjedhje. Rekomandimet e policisë i shkojnë Prokurorit të Përgjithshëm, i cili do të marrë një vendim nëse do të ngrëjë akuza ndaj kryeministrit. Por njoftimi i së martës është tepër shqetësues për zotin Netanyahu dhe mund të bëhet shkak për thirrje për dorëheqjen e tij.

Amerikanët bombardojnë mercenarët rusë në Siri

Të paktën dy luftëtarë rusë u vranë si pasojë e sulmeve ajrore amerikane të javës së shkuar në verilindje të Sirisë. Vdekja e tyre raportohet nga kolegët në terren, mercenarë që mendohet se janë punësuar nga firma private ushtarake që mbështesin trupat e regjimit sirian.

Rusia nuk i konfirmoi raportet për viktimat ruse që fillimisht u shfaqën në mediat amerikane, duke thënë se lajme të tilla nuk duhen konsideruar si burime kryesore. SHBA tha se në sulmet e javës së shkuar u vranë mbi 100 luftëtarë, por Sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis nguli këmbë se nuk ka informacion për kontraktorë rusë të vrarë.

Qindra luftëtarë që mbështesin Presidentin sirian Bashar al-Assad sulmuan javën e shkuar pozicionet në qytetin e Kurshamit të milicive kurde dhe arabe




SDF që mbështeten nga SHBA. Ata kaluan lumin Eufrat dhe sulmuan një bazë të SDF-së ku gjendeshin këshilltarë amerikanë. SHBA u përgjigj me një bombardim të ashpër artilerie dhe ajror, duke i detyruar të zbrapsen dhe duke i shkaktuar shumë

humbje.

Mes këtyre humbjeve dyshohet se janë edhe kontraktorët apo mercenarët rusë. Rusia thotë se nuk ka personel në zonë, diçka që nuk ka pse të jetë gënjeshtëri, pasi mercenarët nuk janë personel i ushtrisë.

BOTIME TË REJA

GJENOCIDI SERB PËRMES NJË MONOGRAFIE



Monografia "Kundër Harresës—Gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998–1999", e autores Fetnete Ramosaj solli për lexuesit e këtushëm solli radiografinë e një pushtuesi, përmes dokumenteve, fotografive, dëshmime personale dhe burimeve të ndryshme arkivore

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 14 shkurt – Dje në Shkup u promovua monografia "Kundër Harresës – Gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998 – 1999", e autores Fetnete Ramosaj. Në këtë monografi, janë të përfshira pesëqind fotografi e faksimile dokumentesh, të cilat e përbëjnë një segment të dokumentimit të gjenocidit Serb ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Këtu trajtohet periudha e luftës së fundit në Kosovë, por edhe materiale të periudhave të më hershme, të cilat e dokumentojnë politikën sistematike dhe afatgjatë gjenocidiale të pushtuesve serb në territoret shqiptare për më shumë se një shekuj. Sipas autores Ramosaj, periudha e fundit e okupimit serb (23 mars 1989 – 12 qershor 1999)

është një nga më tragjikat e popullit shqiptar të Kosovës, i cili u ballafaqua me vrasje, burgosje, helmimin masiv të mijërave nxënësve, dëbimin masiv të punëtorëve shqiptar nga puna, spastrimin etnik, kolonizim, etj. Sipas hulumtimit të autores, në Kosovë, gjatë vitit 1998, të cilin regjimi okupues i Beogradit e konsideronte vit "normal", ishin vrarë e masakruar nga forcat ushtarake – policore e paramilitare serbe 2200 shqiptarë ose për çdo ditë mesatarisht vriteshin 6 shqiptarë. Ishin kidnapuar, marrë peng ose evidentoheshin të zhdukur së paku 1300 të tjerë, 1700 shqiptarë ishin shpërngulur, nga të cilët 175 000 kishin kërkuar strehim në Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë Hercegovinë, Mal të Zi dhe në vendet e tjera të botës. Ishin

shkatërruar afro 45 000 objekte banimi ose pune, fshatra të shkrumbuar tërësisht, plaçkitje të hollash, stoli, mjete transporti, makina bujqësore e kafshë pune dhe ishin shkatërruar të mbjellurat. Po në vitin 1999 mori hov dhuna, terrori dhe aktet barbare dhe duke u bërë të paevitueshme intervenimet e shteteve të botës perëndimore.

Duke folur për monografinë, historiani Skënder Asani tha se autorja ka bërë një retrospektivë historike, kurse periudhat që përshkruhen në këtë libër janë të tmerrshme. Sipas Asanit këto periudha zanafillën e kanë nga shkatërrimet që ndodhën në trojet shqiptare, që mund të quhet edhe projekti më makabër i vitit 1912, për të vazhduar pastaj me pe-

riudha të tjera që kanë reflektuar negativisht në mëkëmbjen e shqiptarëve, e që pati për pasojë masakrat dhe shpërnguljet e popullit shqiptar nga trojet e veta.

Ky libër rikujton historinë e popullit të Kosovës, tha historiani Benisnik Rameti, i cili vuri në dukje faktin se botim, etilla na bëjnë që të mos harrojmë historinë e dhimbshme, por përkundrazi të punojmë e të nxjerrim në pah të vërtetat tona. Ai informoi se autorja ka qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në rrafshin e Dukagjinit, ku edhe përmes pamjeve nga afër ajo ka paraqitur ngjarjet në këtë libër.

Si nikoqir i këtij promovimi, kryetari i kryetarit i Komunës së Çairit, Visar Ganiu, në fjalën e tij përshëndetëse nënvizoi se autorja

përmes këtij libri ruan kujtesën historike të popullit shqiptar të Kosovës. Në promovim u tha se gjatë përgatitjes së kësaj monografie janë përdorur materiale burimore nga arkivat e UÇK-së, KMDLNJ-së, TMK-së, IHKL-së, shtypi ditor e periodik vendor e ndërkombëtar, nga organizatat ndërkombëtare, librat, broshurat, materialet videot televizive, fondet arkivore private, botimet e rralla, si dhe fotografi e dokumente të forcave serbe. Ky libër i rëndësisë së veçantë në rrafshin shkencor historik shërben si shembull për referim edhe nga institucionet akademike e shoqërore në prezantimin e fakteve mbi gjenocidin.

Kjo monografi është një dedikim për publikun shqiptar me rastin e 10 vjetorit të pavarësisë së Kosovës.

KADARE NDJEK INTERPRETIMIN E TENORIT RAMË LAHAJ

Familja e shkrimtarit të madh shqiptar Ismail Kadare ka ndjekur interpretimin e tenorit të njohur shqiptar, Ramë Lahaj, në operën "La Traviata", që po shfaqet në Operën Kombëtare të Parisit.

Përmes një postimi në rrjetin social Facebook, Ramë Lahaj ndan emocionet e tij për pjesëmarrjen e familjes së shkrimtarit në shfaqje dhe e falënderon familjen Kadare për ftesën për të kaluar një mbrëmje së bashku. "Dikur Ismail Kadarenë e njihja vetëm si një prej shkrimtarëve të mëdhenj, ndërsa kësaj radhe kënaqësia e të rikthyerit në Operën e Parisit më dha edhe nderin të kem prezent familjen Kadare në njërin prej shfaqjeve të mia. E veçantë të kalonim një mbrëmje bashkë dhe ju faleminderit për ftesën", shkruan tenori Ramë Lahaj në Facebook.

Tenori shqiptar Ramë Lahaj, gjatë



muajit shkurt po interpreton në operën "La Traviata", të Giuseppe Verdit në Operën Kombëtare të Parisit. Premiera e kësaj opere ishte më 2 shkurt, ndërsa pritet të ketë edhe shfaqje të tjera deri më 28 shkurt, duke numëruar gjithsej 8 shfaqje.

I lindur në Istog të Kosovës, në vitin

1983, Ramë Lahaj, aktivitetin e tij profesional muzikor e filloi në moshën 21 vjeçare, atëherë kur u regjistrua në Akademinë e Arteve të Tiranës, në klasën e profesorit, baritonit shqiptar Burhan Spahiut dhe me konsultime të herë pas herëshme me soprano Suzana Frashëri.

NË MAQEDONI EDHE NJË REVISTË E RE



КРЕАТОРОТ НА НАЈСТАРАТА АВТОМОБИЛСКА РЕВИЈА АВТО ПЛУС

ИМА ОСОБЕНА ЧЕСТ ДА ВЕ ПОКАНИ НА СВЕЧЕНАТА ПРОМОЦИЈА НА НОВОТО МАШКО СПИСАНИЕ

РЕСТОРАН ВОДЕНИЦА, 13 ФЕВРУАРИ 13 ЧАСОТ

"M"-dedikuar meshkujve

Shkup, 14 shkurt- Tregut mediatik në Maqedoni i shtohet edhe revista për meshkuj e cila do të botohet njëherë në muaj. Revista mujore "M" e cila nga dita e sotme është lëshuar në shitje dhe mund të gjendet në të gjitha ato vende ku shiten dhe gazetata tjera të shtypura mund ta blini me çmim prej 30 denarë. Kjo revistë do të trajtojë tema kryesisht nga trendet moderne për veshje të meshkujve si dhe këshilla nga ekspertë të modës lidhur me mënyrat dhe stilet e të veshurit. (Z.V.)

Koha, e enjte 15 shkurt, 2018



REZULTATET:	
SHKUPI - A.PANDEV	5:2
SHKËNDIJA - VARDARI	1-1
RABOTNIČKI - RENOVA	0-0
POBEDA - PELISTERI	1-1
SILEKSI - SKOPJE	(U ANULUA)



Kampioni aktual Vardari nuk arriti të mposht Shkëndijën në Tetovë duke luajtur 1-1, në një ndeshje tejet interesante. Ky rezultat më tepër u konvenon kuqezinjve, të cilët kanë tetë pikë epërsi dhe janë në rrugë të mirë të fitojnë titullin e dytë në historinë e tyre

LIGA E PARË, JAVA E 19-TË

SHKËNDIJA MBETET FAVORIT PËR TITULL, SHKUPI SUPERIOR

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 14 shkurt - Shkëndija dhe Vardari janë ndarë në paqe në derbin e javës së 19-të ose ndeshjes së parë të sezonit pranveror duke luajtur 1-1. Kjo ndeshje u zhvillua me 20-të minuta vonesë, për shkak të borës, e cila kishte mbuluar stadiumin e qytetit në Tetovë. Pas 45 minutave të para rezultati mbetet ai i fillimit 0:0, ndërsa Radeski, Zhunior dhe kapiteni Ferhan Hasani humbën mundësi të mira për të zhblokuar rezultatin, por në të gjitha

rastet, Gaçevski doli fitues. Në pjesën e dytë, u kërcënua Vardari me anë të Popzllatanov, por i njëjti nuk realizoi nga një pozitë ideale. Në vazhdim të pjesës së dytë të dy trajnerët freskuan formacionet, ndërsa pas disa rasteve të humbura, Vardari nëpërmjet Grnçarovit kaloi në epërsi me 0-1. Mirëpo, kuqezinjtë nuk u dorëzuan, dhe pas një aksioni mirë i organizuar, në minutën e 89-Besart Ibraimi barazoi rezultatin në 1-1. I njëjti futbollist mundej të vendos fituesin, por nuk arriti të shënojë nga një pozitë ideale. Pas këtij barazimi Vardari bëri edhe një hap fals në luftën për të mbrojtur titullin, derisa Shkëndija mbetet lidere e tabelës me tetë

pikë epërsi dhe favorite për të fituar titullin e kampionit.

Skuadra e Shkupit në mënyrën më të mirë të mundshme e ka filluar sezonin pranveror. Me rezultatin e thellë 5-2 bardhekaltërit mundën skuadrën e Akademija Pandevit. Ndryshe, trim i ndeshjes te Shkupi ka qenë golashënuesi më i mirë në historinë e futbollit vendor, Blazhe Ilijoski, i cili shënoi hat-trik, edhe atë për vetëm 16-të minuta, derisa i njëjti futbollist në minutën e 56-të humbi mundësinë të shënojë edhe golin e katërt të tij, por gjuajtjen nga pika e bardhë ia ndali portieri mysafir. Fillimisht në minutën e shtatë Ilijoski shënoi për 1-0, dhjetë minuta më vonë shënoi

për 2-0, ndërsa hat-trikun e tij e kompletoi në minutën e 23. Ndërkohë, tre golat tjera për Shkupin i shënuan Jasharovski dhe Stojkovski, ndërsa dy golat për skuadrën mysafire i shënuan Stoilov dhe Griofini. Pas kësaj fitore Shkupi tani mban pozitën e katërt me 26-të pikë, një më shumë se kundërshtari i sotëm.

Renova ka fituar një pikë të madhe në përballjen me Rabotniçkin duke luajtur baras 0-0. Më të mirë për disa nuanca kanë qenë "romantikët", por nuk arritën të shënojnë golin e shumë dëshiruar. Pa fitues ka përfunduar edhe përballja mes Pobodës dhe Pelisterit 1-1. Manevski e kaloi në epërsi Pelisterin,

mirëpo Danoski ka barazuar rezultatin në 1-1. Pas këtij barazimi Pobeda gjendet në pozitën e shtatë, ndërsa Pelisteri në pozitën e parafundit, pozitë kjo e cila e qon atë në Ligën e dytë.

Për shkak të të reshurave të mëdha të shiut, ku fusha në Kratovë mbeti pothuajse e mbuluar me ujë, përballja ndërmjet Sileksit dhe Skopjes nuk u luajt. Referi kryesor Marjan Markovski, pas konsultimeve që kishte me kapitenët e ekipit, solli vendim se kushtet për lojë në stadiumin në Kratovë nuk ka, me çka vendosën që e njëjta të anulohet. Derisa, u caktua termini i ri për këtë ndeshje kampionale dhe ajo do të jetë 21 shkurti.

Publicitet

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Projekt A - leje e integruar ekologjike për ADING AD Shkup
nr. 1409 nr. 11

Gjorge Petrov, 1060 Shkup

Instalacioni ADING AD Shkup paraqiti kërkesë deri te MMJPH për marrjen e A - Lejes për harmonizim me planin operativ. Pas zbatimit të procedurës ligjore, MMJPH lëshoi A - Leje për harmonizim me planin operativ nr. 11-416 / 3 nga 13.01.2014.

Rrjedhimisht, pas dorëzimit të njoftimit nr. 11-10520 / 38 nga 22.11.2014. nga ana e instalacionit dhe inspektimit të kryer në prani të inspektorit shtetëror të mjedisit nga 28.12.2014. (në pajtim me nenin 138, paragrafët 6 dhe 7 të Ligjit për mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 53/05, 81/95, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15., 129 / 15,192 / 15 dhe 39/16) MMJPH e zbaton procedurën e mëtejshme për dhënien e A-Lejes së integruar ekologjike.

Instalacioni sipas Regullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve i takon aktivitetit nga Shtojca I, Pika:

Shtojca I, Pika:

4.1 Instalacione kimike për prodhimin e kemikateve bazike organike, si që janë:

4.1 (b) hidrokarbonate që përmbajnë oksigjen si që janë: alkoolet, aldehidet, ketonet, acidet karboksile, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, smollat epokside;

4.2 Instalacione kimike për prodhimin e kemikateve bazike inorganike, si që janë:

4.2 (g) kripërat siç janë: kloridi i amonit, klorati i kaliumit, karbonati i kaliumit, karbonati i natriumit, perborati, nitrati i argjendit;

Kapaciteti i projektuar: 20 000 ton në vit.

Drejtorja mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,
Projekt A - Leje të integruar ekologjike për për ADING AD ShkupProjekt Leja do jetë e shpallur, në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mkInformacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në tel: 070 243 398 (e-mail: s.qigorova@moep.gov.mk).

Të interesuarit, në afat prej 14 ditëve nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet ti dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në këtë adresë: Bulevardi "Goce Delçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV kati 10), 1000 Shkup.

Van Basten udhëheqës i delegacionit të FIFA-s

Shkup, 14 shkurt - Marko van Basten, futbollisti legjendar holandez, tani në rolin e drejtorit teknik për zhvillim të FIFA-s, do të udhëheqë delegacionin e shtëpisë së futbollit botëror me rastin e hapjes së kapacitetit për akomodim në kompleksin "Shtëpia e futbollit" të enjten (15 shkurt). Përveç golashënuesit legjendar Van Basten, mysafirë të presidentit të Federatës së Futbollit të Maqedonisë, Ilčo Gjorgjioski do të jetë edhe presidenti i UEFA-së, Aleksandar Čeferin, drejtori i sektorit për Asociacione Kombëtare pranë UEFA-së, Zoran Lakoviç dhe Bojrn Vasalo, drejtori i Seleksioneve Kombëtare pranë FIFA-s. Nga FFM njoftojnë se objekti i ri në kuadër të kompleksit "Shtëpia e futbollit" përmban hapësira akomodimi për nxënësit e FFM-së dhe Akademisë elite të UEFA-së, si dhe për ekipet e reja përfaqësuese. Objekti është plotësisht i pajisur për



të jetuar me 30 dhoma dy krevatëshe, apartamente për seleksionuesit dhe stafet teknike, si dhe hapësira të përbashkëta – palestira për mbledhje, klasa dhe kuzhinë të përbashkët me dhomë për ngrënie. Hapësirat për akomodim janë të projektuara për qëndrim të studentëve të Akademisë së futbollit gjatë vitit shkollor, ndërsa sipas nevojës do të shfrytëzohen edhe për ekipet e reja nacionale para ndeshjeve.

LLOGARITË E FIDE-S BLOKOHEN SI PJESË E SANKSIONEVE NDAJ ASSAD

SHAHU MBETET PA PARA

Federata thotë është vendosur në një pozitë të vështirë dhe në kërkim të një banke tjetër për të mos dëmtuar këtë sport dhe aktivitetet e parashikuara përgjatë këtij viti. Vetë Ilyumzhinov mohon akuzat, por SHBA këmbëngul se përmes tij, qeveria siriane e Bashar al-Assad, e vendosur nën sanksione për shkak të konfliktit të përgjakshëm ka kryer transfera bankare

Presidenti i Federatës Botërore të Shahut (FIDE), Kirsan Ilyumzhinov është vendosur në listën e sanksioneve të Departamentit të Thesarit të Shteteve të Bashkuara për lidhjet me qeverinë e Assadit. Kjo ka vendosur në një situatë të pashembullt këtë federatë, e cila konfirmoi këtë të mërkurë se ka marrë një njoftim nga bankat zvicere për mbylljen e llogarive të tyre financiare. Federata thotë është vendosur në një pozitë të vështirë dhe në kërkim të një banke tjetër për të mos dëmtuar këtë sport dhe aktivitetet e parashikuara përgjatë këtij viti. Vetë Ilyumzhinov mohon akuzat, por SHBA këmbëngul se përmes

tij, qeveria siriane e Bashar al-Assad, e vendosur nën sanksione për shkak të konfliktit të përgjakshëm ka kryer transfera bankare. Ilyumzhinov njihet si figurë kontraverse. Për 17 vite me radhë ai ka drejtuar Republikën e Kalmakas, një rajon i vogël budist në Rusi, i ndodhur në brigjet e Detit Kaspik. Vite më parë, deklaronte në televizion se kishte takuar alienët në bordin e anijes së tyre. Si President i FIDE-s që prej 1995 ka shpenzuar miliona dollarë për ta shndërruar rajonin e vogël rus në një Mekë të shahistëve, duke ndërtuar edhe një fshat të tërë për organizimin e turneve ndërkombëtarë.



Publicitet

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-2498/14 dt. 07.02.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 33, komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 33KK Tetovë 1, komuna e Tetovës** me nr. teknik 12-1/16 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë.

Kufiri i përfshirjes planore definohep përmes rr. "Marshall Tito (Ilirija)", rr "Bllagoja Toska", "Boris Kidriç (Metodi Antonov Cento)" dhe „120„.

Përfshirja është me sipërfaqe prej 4.1 ha.

ANKETA PUBLIKE E PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 33, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 21.02.2018 – 27.02.2018.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIKI PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 33, nëkomunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 22.02.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Planit detal urbanistik në Bllokun Urban 33, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

I nr. 1823/2017

SHPALLJE PUBLIKE
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016)

Përmbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përmbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti - Gostivar, kundër borxhlinjve 1. Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë 2. Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, 3. Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 12.02.2018:

FTON
Borxhlinjtë Xhezmi Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Gjuzazije Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, Fatime Emro nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236 për shkak të dorëzimit të:

Konkluzionit për shtyrje të përmbarimit në bazë të nenit 91 paragrafi (1) të LP L nr. 1823/2017 të datës 15.01.2018 të Përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit. PARALAJMËROHEN borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjuzazije Emro, Fatime Emro dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai, se mënyra e këllitë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzimit i regullit dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.

KJO PARAQET SHPALLJEN E PARË.

Përmbarues
Aleksandar Kuzmanovski

SHPALLJE

SHMK "Kosta Susinov" Radovish publikon shpallje për **Realizim të ekskursionit shkollor** me nxënësit e vitit të tretë pranë SHMK "Kosta Susinov" Radoish. Kohëzgjatja e ekskursionit është gjashtë ditë me tre bujtje, dy bujtje në San Remo dhe një bujtje në Lido Di Jesolo me vizitë në Milano, San Remo, Kanë, Nica, Monako, Monte Karlo, Venecia dhe Verona, në pajtim me programin.

Kushtet që duhet të plotësojë ofertuesi janë si në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për realizim të veprimtarisë përkatëse turistike,

- në mënyrë të suksesshme të ketë të realizuara së paku tre ekskursionë shkollorë dhe aktivitete tjera gjatë tre viteve të fundit, (të dorëzojë tre rekomandime nga drejtorët të shkollave për realizim të suksesshëm të ekskursioneve).

- të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion dhe rrugë dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur duhet të sigurojë garanci bankare për realizim të kualitetit të marrëveshjes prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Ofertuesi i shërbimit të plotësojë kushtet teknike minimale për përgatitje të autobusëve për realizim të ekskursioneve me çka autobusët të jenë të klimatizuar dhe me televizorë.

Ofertuesi i shërbimit duhet të sigurojë përfaqësues të agjencisë gjegjësisht udhëheqës për secilin autobus, gjatë vizitave të lokaliteteve të ketë të organizuar udhëheqës lokal, 9 mësimdhënës, sigurim të mbrojtjes përkatëse shëndetësore, me prezencë të mjekut dhe pajisjes së nevojshme mjekësore për ndihmë të parë të përshatshme për kushte rrugore dhe në fushë.

Çmimi në ofertë duhet të jetë fikse, gjegjësisht nuk lejohet korrëgjim i çmimit gjatë realizimit të marrëveshjes. Ofertuesi duhet të dorëzojë çmim të përvetshëm (për nxënës) të shërbimit në të cilin çmim do të përfshihen kushtet për akomodim (së paku hotel me 3 yje, gjatë dorëzimit të ofertës të dorëzojnë edhe emrat e hoteleve), menya për ushqim (me mënjësi dhe darkë të organizuar në hotelin ku qëndrohet) dhe transporti, sigurimi rrugor dhe shëndetësor i nxënësve, bileta për vizitë të të gjitha vendeve të njohura dhe organizim të mbrëmjes argëtuese (një disko mbrëmje).

Në ofertë të caktohet mënyra e pagesës me mundësi me katër këste mujore, duke përfshirë kushte për nxënës që vijnë nga familje të preкура sociale, i lirime për pagesat në dorë (10%) dhe lirime për më shumë anëtarë të familjes (30%).

Një ditë para realizimit të ekskursionit, drejtori i shkollës nga transportuesi i cili do të realizojë udhëtimin duhet të ketë dëshmi për rregullsinë teknike të makinës për transport publik në pajtim me ligjet ekzistuese në fuqi në R. të Maqedonisë, procesverbal për realizimin e kontrollit të jashtëzakonshëm teknik të autobusëve, jo më të vjetër se një muaj si dhe kopje të lejeve të qarqullimit të makinave. Vozitësi i autobusit të ketë certifikatë të mjekut jo më të vjetër se gjashtë muaj dhe vërtetim nga personi përgjegjës të transportuesit se nuk ka vozitur 12 orë para nisjes.

Shpallja zgjatë pesë ditë pune nga dita e publikimit.

Oferta me tërë dokumentacionin me të cilin dëshmohep se ofertuesi përmbushë kushtet minimale dhe të posaçme për realizim të ekskursionit (dokumentacion ndaj secilit kusht të caktuar në shpallje publike) duhet të dorëzohet në arkivin e shkollës në adresën SHMK Kosta Susinov - Kej 8 Radovish, në zarf të mbyllur me shenjë "OFERTA" sipas shpalljes publike për ekskursion përfundimtar dhe shënim "Mos hap".

Kontaktet: kostasusinov@yahoo.com, 032 635 437

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 34/14 dhe 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27/16), ndërsa në pajtim me lajmërimin nga MASH nr. 12-1041/1 të datës 29.01.2018 me kërkesë të Qytetit të Shkupit 25/08-769/2 të datës 02.02.2018 dhe lajmërimin të Ministrisë së financave nr. 18.13137/2 të datës 25.12.2017, në kuptim të nenit 59 dhe 60 të Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 0116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15 dhe 30/16), në bazë të Statusit të SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup, Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit publikon

Shpallje

Për punësim për kohë të pacaktuar të punës – Financim i vjetër

1.1. Një (1) mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës për kohë të PACAKTUAR të punës. Kandidatët duhet të kenë të mbaruar arsimin fillor, teknik ose gjimnaz me neto pagesë mujore 12.000 denarë + shtesë e punës së kaluar në shumë prej 0.5% për çdo vit, orari punës është me dy ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12.00 deri në ora 20.00.

1.2. Një (1) Nikoqir me orar të plotë të punës për kohë të PACAKTUAR të punës. Kandidatët duhet të kenë të mbaruar arsimin teknik ose gjimnaz me neto pagesë mujore 15.000 denarë + shtesë e punës së kaluar në shumë prej 0.5% për çdo vit, orari punës është me dy ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 06.00 deri në ora 14.00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12.00 deri në ora 20.00.

2. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë:

- Fletëparaqitje sipas shpalljen publike
- CV – biografi të shkurtë
- Diplomë ose Certifikatë për arsimin e mbaruar përkatës (kopje të vërtetuar në noter).
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët mund të jenë me ose pa përvojë pune.

Shpallja publike do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa vendimi për pranim do të sillët në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup në rr. Llazo Trpovski pn.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

3. Vendimi futet në fuqi me ditën e sjelljes së saj

Ndaj të lartpërmendurës sillët vendim sikurse në dispozitiv.

DREJTOR
Faruk Zekiri

SULMUESI
SLOVAK
SHPREHET
OPTIMIST

KA ARDHUR KOHA E NAPOLIT



"Kemi luajtur më shumë se gjysmën e sezonit dhe jemi kokë më kokë me Juventusin. Klubet e tjera janë larguar. Mbase nuk do të ndodhë më në vitet e ardhshme—prandaj duhet të mundohemi me të gjitha forcat të fitojmë këtë sezon", pohon Hamšík

Marek Hamšík beson ka ardhur koha që Napoli të fitojë titullin e Serie A dhe zbulon punën e madhe që duhet të bëjë skuadra nën drejtimin e Sarrit. "Që nga momenti i parë që mbërrita këtu e kuptova menjëherë se sa i rëndësishëm është futbollit për napolitanët. Është si një fe apo një sëmundje që të shoqëron çdo ditë. Pas kaq shumë vitesh kam një marrëdhënie tepër të veçantë me tifozët", u shpreh Hamšík. Stili i bukur i futbollit që ka implementuar Sarri ka fituar zemrat e të gjithë botës, por nuk është e lehtë të mësohet kollaj nga blerjet e reja. "Është e bukur për t'u parë, por shumë e vështirë për t'u implementuar. Duhet të vrapojmë shumë, të bëjmë presing. Nuk është futboll i thjeshtë. Nëse rifitojmë topin, atëherë mund të fokusohemi te forca jonë—mbajtja e topit. Gjatë javës gjith-

monë luajmë në stërvitje me vetëm dy të prekura të topit. Në mënyrë që të lëvizim topin sa më shpejtë. Por nëse topi shkon te një nga sulmuesit ata janë të lirë të driblojnë. Sarri është një duhanpirës i apasionuar. Nuk kam parë njeri të tymosë si ai. Kur jemi në fushë ai pret shumë nga ne. Ndërsa jashtë saj ai është një njeri i qetë, bën shaka dhe është shumë i shoqërueshëm", nënvizoi më tej Hamšík.

"Kemi luajtur më shumë se gjysmën e sezonit dhe jemi kokë më kokë me Juventusin. Klubet e tjera janë larguar. Mbase nuk do të ndodhë më në vitet e ardhshme—prandaj duhet të mundohemi me të gjitha forcat të fitojmë këtë sezon. Juve është një klub i klasit botëror me vlerë 600 milionë euro. Nuk mund të krahasohemi me këtë. Por jemi pranë arritjes së diçka të pabesueshme dhe duam t'i mundim. Jam i sigurt se ka ardhur koha e Napolit", përfundoi sulmuesi slovak.



Interi është klubi i madh, më pëlqen Premier Liga

"Mesa di unë gjatë merkatos së janarit ka ardhur një ofertë e pabesueshme, por unë e kam lënë gjithçka në dorë të menaxherit. Nëse ai do të mendonte të arsyeshme largimin atëherë do të ikja nga Inter. Gjithsesi, jam i lumtur për interesimin e klubeve të mëdha, ashtu si jam i lumtur që Interi, një tjetër klub i madh, ka vendosur mos më shesë", nuk kanë qenë fjalë çfarëdo ato të thëna nga Milan Skriniar gjatë një interviste, për një të ardhmen e tij, që mund të jetë larg nga Milano. "Në cilin "top club" do të doja të luaja? Real Madrid dhe Barcelona më pëlqejnë shumë, por e njëjta gjë vlen për dy ekipet e Mançester. Për më tepër, Premier Liga është kampionati më i bukur në botë", nënvizoi më tej slovaku. 23-vjeçari nuk e fsheh se mendon skuadra të tjera krahas Interit, gjithmonë nëse do të jetë titullar. "Largimi im do të varej nga disa faktorë, si për shembull marrëveshja mes klubeve dhe roli që do të kem aty ku do të shkojë. Nëse do të jem në stol atje ku do të shkoj, atëherë zgjedh të qëndroj përjetësisht te Interi". Në fund, Skriniar shtoi: "Liga e kampionëve është objektivi që kemi në këtë sezon. Sigurisht që kur ishim në krye nisëm të mendojmë edhe për titullin, por tani i përket gjithçka së kaluarës dhe ne synojmë të arrijmë mes katër të parave. Nuk duhet të humbasim më pikë rrugës, sepse jemi në vend të tretë dhe gjithçka është në dorën tonë", përfundoi Skriniar.



Raiola i ofron Ikardit kalimin te Mançester Junajtedi

Mino Raiola dëshiron të veprojë si një ndërmjetës, për ta dërguar Mauro Icardin te Manchester United në verë, raporton "Corriere dello Sport". Superagjenti i futbollit duket se synon të marrë përsipër përfaqësimin kryesor të Icardit, megjithëse sulmuesi i Interit është i lumtur të vazhdojë të punojë me agjentin aktuale, njëherazi gruaja e tij, Vanda Nara. Kjo e fundit, me sa duket është në procesin e negociimit të një marrëveshjeje të re me Interin, megjithëse Raiola ofron gatishmërinë e të punuarit për një transferim të argjentinasi në "Old Trafford". Diskutimet aktuale mes Vanda Nara dhe klubit zikaltër

ende nuk kanë filluar, por të dyja palët kanë konfirmuar gatishmërinë e tyre për t'u marrë me këtë çështje në kohën e duhur. Po, çfarë ka ndërmend të propozojë "Corso Vittorio Emanuele" për Vanda dhe për pjesën tjetër të shoqërimit të sulmuesit, domethënë agjentët Ulysses Savini dhe Pino Letterio? Do të fillojë me një rritje prej pothuajse 2 milionë euro, krahasuar me pjesën aktuale fikse të angazhimit financiar, pastaj nga 4.7 në 6.5 milionë euro. Në këmbim, Interi do të dëshironte ta anulonte klauzolën krejtësisht. Ndërsa, përveç kësaj, do të kishte një grup të pasur shpërblimesh, të lidhura me

qëllimet e ekipit dhe madje, edhe ato personale. Këto do të ishin shpërblime thelbësore, disa më të lehta për t'u arritur, të tjerat më pak, por ende në gjendje për ta rritur kapitalin zikaltër. Si në të gjitha negociatat, në fazën e parë, distancat mbeten të rëndësishme, por jo të paarritshme. Tashmë, për pjesën e pagës së garantuar, Vanda fillon nga një kërkesë prej 7 milionë euro, por në të njëjtën kohë, klauzola nuk do të eliminohej, por vetëm do të rritej: deri në 150 milionë euro, por me disponueshmërinë edhe për të arritur 200.

Barça-Arthur, marrëveshje për zbatim në janar 2019

Pas mbylljes së merkatos së dimrit dhe afrimit të Filip Kuutinjo (25 vjeç) dhe Jerry Mina (23 vjeç), sekretariati teknik i Barcelonës është tashmë në rrugën e duhur të nënshkrimit me një lojtar të ri. Ky është Arthur Melo, mesfushori 21-vjeçar i Porto Alegre Gremio, i cili u zgjodh "MVP" në finalen e fundit të "Copa Libertadores". Parashikimi është se Arthur nuk arrin te Barcelona deri në janar 2019. Sigurisht, nga klubi katalanas theksojnë se kjo mund të ndryshojë në varësi të performancës që Jerry Mina

mund të ofrojë deri në verë. Hapat e nisura në dhjetorin e kaluar nga Andre Kury, një punonjës i Barçës në Amerikën e Jugut, dhe Robert Fernandez, sekretari teknik i Blaugranave, kanë përfunduar duke sjellë fryte. Ata u takuan me lojtarin, agjentin e tij, Jorge Maçado, dhe familjen për të hetuar nëse pre-dispozicioni ishte i plotë, siç u evidentua tashmë me imazhet e rrjedhura nga Arthur, i veshur me fanellën azulgrane. Ky fakt krijoi një pakënaqësi te Gremio, por ndërhyrja e shpejtë e përfaqësuesve të klubit dhe vetë

Arthur ka shërbyer për ta qetësuar klubin e Porto Alegre, i cili kërcënoi me padi në FIFA. Sipas asaj që zbulon "Mundo Deportivo", Barcelona tashmë ka nënshkruar një marrëveshje me lojtarin, me anë të agjentit të tij, që pritet të ekzekutohet në janar 2019. Mbetet vetëm për t'u përfunduar një negociim, që është në rrugë të mirë me Gremio, e cila zotëron 60 për qind të të drejtave të lojtarit, ndërsa investitori "Celso Rigo" ka 20%. 20 për qind të tjera i takojnë Arthurit dhe familjes së tij, kështu që kjo pjesë nuk është pengesë.



ALEGRI FLET PAS BARAZIMIT 2-2 ME TOTENHEMIN



NË LONDËR DO TË JETË NJË FINALE

Ne e dinim se do të ishte një ndeshje e vështirë. Jemi përballë Tottenhamit në Ligën e Kampionëve, një ekip fizik dhe teknik. Tani, në Londër, do të jetë një finale dhe do të duhet të luftojmë për ta kaluar me sukses”, – pohon Allegri

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, hodhi poshtë kritikën ndaj skuadrës së tij, pas barazimit të Ligës së Kampionëve me Tottenhamin, duke thënë se kundërshtari ishte “i çmendur”. Gonzalo Higuain shënoi një dopietë të hershme në ndeshjen e parë të 1/8 finale, në Torino, të martën, por humbi një penallti në fund të gjysmës së parë. Harri Kin kishte ngushtuar rezultatin me një gol për “Spurs”, teksa këta të fundit barazuan 2-2 në sajë të një goli të Eriksen, në pjesën e dytë. Allegri, i cili pret që Paulo Dybala dhe Blaise Matuidi të kthehen për ndeshjen e kthimit, tha se pritshmëritë që Juve do ta vriste ndeshjen që në Torino ishin të pavendosura. “Juventusiu luan për të fituar Ligën e Kampionëve, por ne nuk jemi favoritë për këtë. Është e pamundur të arrijmë në finale çdo vit”, – tha trajneri bardhezi. “Ne po bëjmë më të mirën dhe lojtarët e mi duhet të jenë të lumtur, sepse ata kanë zhvilluar një sezon të mahnitshëm. Edhe unë jam i lumtur për atë që po bëjnë. Ne e dimë se duhet të përmirësohemi. Ende kemi një shans të mirë për t’u kualifikuar në Londër, por është krejtësisht e çmendur të mendojmë se Juventusiu duhet të fitojë 3-0 në raundin e 1/8 finale të Ligës së Kampionëve.

Është diçka që më bën të çmendur, sepse nuk jeni në gjendje të analizoni se sa ekipe të mira janë në Ligën e Kampionëve. Unë nuk mund të pranoj që njerëzit mendojnë se rezultati 2-2 ndaj Tottenhamit mund të na bëjë të depresionuar”, nënvizoi më tej Allegri. Ai tha se skuadra e tij kurrë nuk ishte favorite kundër “Spurs”, ndërsa përgatitet për një “finale” në ndeshjen e dytë, në “Wembley”, muajin e ardhshëm. “Ne patëm një shans 50 për qind përpara ndeshjes së parë dhe ende kemi 50 për qind mundësi kualifikimi për më tej. Tottenhami është një skuadër e mahnitshme. Gjithsesi, futbollit është i çuditshëm, sepse Buffon na shpëtoi kur ishim 2-0. Pastaj patëm mundësinë të shkojmë përpara 3-0. Rezultati u ngushtua 2-1. Mund të shkonim 3-1 me penallti, por Higuain e humbi atë. Ne e dinim se do të ishte një ndeshje e vështirë. Jemi përballë Tottenhamit

në Ligën e Kampionëve, një ekip fizik dhe teknik. Tani, në Londër, do të jetë një finale dhe do të duhet të luftojmë për ta kaluar me sukses”, – përfundoi Allegri.

KIN: TREGUAM KARAKTER, MORËM REZULTAT SHUMË TË MIRË

Harri Kin ka thënë se skuadra ka treguar karakterin e Tottenhamit pasi ishin duke humbur 2-0, dhe e riktheu rezultatin në 2-2. “Ne kemi mundur të dështojmë kur ishim 2-0 në një ndeshje si kjo në Ligën e Kampionëve, por ne kemi treguar karakterin e skuadrës. Bëmë një paraqitje të shkëlqyer pas kësaj, dhe e merituar që të kthehemi në lojë. Kur e shikon, dy gola si mysafirë dhe kthimi me një barazim në ‘Wembley’, është rezultat i shkëlqyeshëm. Kisha një rast të mirë para golit me kokë, u desh ta

shënoja atë, por prita për këtë të dytin. Dele Alli dha një pasim shumë të mirë dhe u desh që ta ktheja në gol. Na ktheu në lojë dhe ajo ishte e rëndësishme”, deklaroi Kin.

GUARDIOLA: JEMI POTHUAJSE NË ÇEREKFINALE

Pep Guardiola ishte i kënaqur me performancën e Manchester City në Basel, në mbrëmjen që i vë “qytetarët” në shortin e çerekfinaleve të Ligës së Kampionëve, më 16 mars. Manchester City fitoi 4-0 në Basel, që do të thoshte se duhet një mrekulli në stadiumin “Etihad”, më 7 mars, që të besuarit e Guardiolas të mos arrijnë në çerekfinale për herë të dytë në historinë e klubit. “Është një rezultat i mrekullueshëm në këtë raund të këtij kompeticioni”, – tha Guardiola. “Sidohet, një raund në Ligën e Kampionëve zgjat 180 minuta. Të presim, edhe pse jemi pothuajse aty, në çerekfinale. Unë nuk jam duke thënë se gjithçka është bërë, sepse në futboll çdo gjë mund të ndodhë, por është një rezultat i mahnitshëm. Jam i kënaqur dhe tani do të përgatitemi për ndeshjen me Viganin”, deklaroi Pep.

HIGUAIN VENDOS REKORD

Sulmuesi argjentinas i Juventusit, Gonzalo Higuain, ka vënë rekordin e ri në “Champions League” duke shënuar dygolëshin më të shpejtë në historinë e kësaj veprimtarie. Higuain shënoi golin e parë në minutën e dytë, pas pasimit të marrë nga Pjaniç dhe në minutën e tetë realizoi golin e dytë me 11-metërsh. Higuain e shënoi golin e dytë pas tetë minutash e shtatë sekondash, duke thyer rekordin e Julio Kruz, i cili kishte shënuar dy gola në ndeshjen ndaj rusëve të Spartak Moskë në 8 minuta e 30 sekonda në tetor të vitit 2018.



Vatzke mbetet shef ekzekutiv i Dortmundit

Ajo që po përflitej prej ditësh tashmë është bërë realitet. Hans-Joachim Vatzke ka rinovuar kontratën me Borussia Dortmundin deri në vitin 2022. Shefi ekzekutiv i verdhezinjve ka pasur një rol kyç në sukseset e skuadrës, sidomos në ato financiare gjatë dekadës së fundit, ndaj drejtuesit e klubit nuk kanë

hezituar për t’i ofruar një kontratë të re, që i skadon pas katër vitesh. Në një komunikatë zyrtare, presidenti Reinhard Rauball vlerësoi punën e 58-vjeçarit, duke i dhënë besim të plotë në menaxhimin sportiv edhe për vitet që do të pasojnë. Dortmundi është një klub i shëndetshëm financiarisht, sidomos pas shitjes

së Ousmane Dembele te Barcelona dhe Pierre-Alexandre Aubameyang tek Arsenali për shifra rekord, që bashkë me bonuset në total mund të kalojnë 200 milionë euro. Emërimi i Jurgen Klopp në krye të skuadrës në vitin 2008 konsiderohet si “çelësi” i nisjes së një epokë të re të verdhezinjtë.

LAJME SHKURT

Asensio ka tri oferta nga klubet e mëdha

Manchester Junajted, Manchester Siti dhe Bayern Munihi janë vënë pas mesfushorit të Real Madridit Marko Asensios. Sipas gazetarit të Okdiario, Eduardo Inda, tri klubet e njohura vetëm ka bërë ofertë për lojtarin. Sipas Inda lojtari mund të ndryshojë mjedis në verë, edhe pse Real Madridi ka thënë disa herë që nuk e ka ndërmend ta shes. “Asensio ka oferta nga Bayerni, Siti dhe Junajted, por Reali e cilëson të pasitur mesfushorin”. Asensio edhe pse nuk është lojtar i formacionit ka arritur të shënojë tetë gola. Zinedin Zidane e ka futur nga minuta e parë vetëm në dy nga tetë ndeshjet e fundit. Real Madridi sonte luante ndaj PSZH-së në njërin nga ndeshjet më interesante të Ligës së Kampionëve.

Klauzolë dhe rritje page për portierin Allison

Roma nuk dëshiron të humbasë shërbimet e Allison Becker dhe për këtë mendon t’i vendosë një klauzolë të lartë largimi portierit. Klubi verdhekuq për të larguar interesin e disa klubeve si Liverpool dhe Real Madrid, që e kërkojnë prej kohësh 25-vjeçarin, synon t’ia vendosë 90 milionë euro çmimin e largimit “gardianit” brazilian. Kjo do të thotë që nga 1.5 mln euro që përfiton aktualisht Allison, me kontratën e re të arketojë 5 milionë Euro.

Eardhmja e Reinas larg Napolit

Edhe pse kanë rënë në qetësi zërat për të ardhmen e Pepe Reina, duket se portieri nuk do të vazhdojë qëndrimin te Napoli. Gjatë merkatos së janarit, u përfol shumë për një largim të mundshëm të tij nga të kaltrit, por në fund spanjollit qëndroi. Megjithatë mediat italiane raportojnë së agjenti i tij, Quilon, këto ditë është vendosur në lëvizje për të gjetur një skuadër të re për 35-vjeçarin, titullar në ekipin e Sarrit. Në fakt, në përfundim të sezonit drejtori sportiv i Napolit, Giuntoli, duhet të gjejë dy portierë, sepse në skadencë kontrate është edhe braziliani Rafael.



DASHI 21. mars - 20. prill
Dite jo shume e mire kjo e sotmja për te gjithë ata qe janë ne një lidhje. Do debatoni ashpër me partnerin tuaj sidomos për tema shume delikate qe kane mbetur pezull nga e kaluara. Beqaret nga ana tjetër do kenë mundësi reale për te krijuar një lidhje serioze. Ne planin financiar duhet te shmangni transakcionet shume te mëdha dhe te nxituara.

DEMI 21. prill - 21. maj
jeta juaj ne çift do jete e bukur dhe mjaft harmonike gjate kësaj dite. Do bashkëpunoni gjithë kohës me atë qe keni ne krah dhe do dashuroheni ashtu si e ndjeni. Beqaret do kenë një dite premtuese edhe pse nuk mund te fillojnë menjëherë një lidhje. Me financat duhet te vazhdoni te tregoheni te matur dhe larg-pamës. Mos mendoni vetëm për kënaqësitë e momentin.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Mos bëni asgjë sipas mendjes suaj gjate kësaj dite, por për gjithçka flisni me pare me personin qe keni ne krah. Ne këtë mënyrë do shmangni edhe mosmarrëveshjet e shumta. Beqaret do gjenden përballë dilemave te mëdha dhe do iu duhet kohe për t'u menduar. Konfigurimi i yjeve do jete pozitiv për sektorin e financave. Situata do filloje te stabilizohet ndjeshëm.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Dite plot diell kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do jeni mjaft sensuale dhe do ia shprehni me tepër ndjenjat atij qe keni ne krah. Ai nga ana e tij do mendoje t'iu surprizojë ne çdo moment. Beqaret nuk do jene ne humor shume te mire për te krijuar një lidhje. Financat do jene te ndërlikuara kështu qe bëni shume kujdes me shpenzimet qe do kryeni.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Çdo gjë do ece me se miri sot ndërmjet jush dhe atij qe keni ne krah. Do flisni lirshëm për gjithçka, madje do thurni edhe plane për te ardhmen. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim te shpirtit binjak dhe nuk do ndalen për asnjë moment. Financat do kenë disa tronditje te vogla. Nuk ka ardhur ende koha te kryeni shpenzime marramendëse.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Do bëni çmos gjate kësaj dite për ta përmirësuar jetën ne çift dhe ka gjasa qe t'ia dilni mbanë me sukses. Komunikimi me partnerin nuk do shteroje për asnjë moment dhe kjo do jete pika juaj me e forte. Beqaret duhet te tregohen me te kujdesshëm dhe te mos nxitohen nëse dikush ju bën një propozim. Ne planin financiar duhet te ndiqni një strategji fikse qe t'ia dilni mbanë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Lidhja juaj ne çift do thellohet edhe me tepër gjate kësaj dite. Do bini ne një mendje për një vendim qe iu duhet te merrni dhe do bëni zgjedhjen e duhur. Beqaret nuk do guxojnë te hedhin hapat drejt një lidhjeje pa qene te sigurte se ai është personi ideal. Financat do jene me te ekuilibruara se kohet e fundit. Hiqni disa para mënjanë qe te siguron e dhe te ardhmen.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Dite pozitive kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje megjithatë emocionet nuk do jene aq te fuqishme sa pritshin. Tregohuni me te duruar dhe me tolerante me personin qe keni ne krah. Beqaret do vazhdojnë te mbeten vetëm edhe pse nuk do rreshtin për asnjë moment se kërkuari. Ne planin financiar mos u tregoni impulsive sepse do bëni gabime fatale.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Mos i kërkoni gjera te pamundura partnerit tuaj gjate kësaj dite, por nga ana tjetër, mos u tregoni as shume xheloze me te. Dita e sotme nuk do jete aspak pozitive për ata qe janë ne një lidhje. Beqaret do kenë takime pa fund dhe do arrijnë ta bëjnë për vete një person interesant. Financat do jene goxha te favorshme. Beni investimet me te rëndësishme ne fillim!

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Marrëdhënia me partnerin do ketë përmirësime te ndjeshme gjate kësaj dite. Do flisni hapur me te dhe do tregoheni me te kuptueshëm. Për beqaret jeta sentimentale do ketë rëndësi shume te madhe. Ata do kërkojnë ne çdo vend qe te mundin sot për te aritur atë qe dëshirojnë. Ne planin financiar do kryeni transakcione dhe investime me rëndësi te madhe.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Do ndiheni te lënë pas dore gjate kësaj dite nga ai qe keni ne krah dhe kjo do iu brengose pa mase. Flisni me te hapur dhe jepini zgjidhje problemit. Beqaret do jene shume impulsive dhe mund te bëjnë disa gabime te vogla. Kujdes sepse është jeta juaj jo e dikujt tjetër. Financat do kenë disa vështirësi kështu qe merrni masa strikte për ta stabilizuar situatën.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Do ndihen me afër partnerit tuaj gjate kësaj dite dhe marrëdhënia me te do jete e mrekullueshme. Secili prej jush do mundohet t'ia plotësojë dëshirat tjetrit. Beqaret do i marrin gjerat si t'iu vijnë dhe nuk do kërkojnë me ngulm te krijojnë një lidhje. Te ardhurat do fillojnë te kenë disa përmirësime. Mund te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër sesa zakonisht.


shummë i lehtë

5						1		
	3		7		9			
9	6		5				3	7
	4				6	3	9	
	9	5	8				6	
6					1			
			2	9		3	7	4
			9				6	
								3

**Sot më 15 shkurt 2018 bëhen
DYMBËDHJETË VJET PA TY**



Shaban Murati
Ditët, vitet, po kalojnë, por mungesa jote ndihet gjithmonë në zemrat tona.
Nga familja.



NE KETE DATE

15 SHKURT 1954

Mensur Mamuti	KARIKATURISTI AMERIKAN NE FOTO	PARASHITESË PËR GJERAT QË KANE TE BEJNE ME AVIACIONIN	QYTETI I LINDJES SË KARIKATURISTIT NE FOTO	PJESË ANESORE
HARTA				
KOMPANI AMERIKANE PËR SHITJEN E KOZMETIKES				
KADE E MADHE, DRURI PËR VERË, TINAR				
FIS I VJETËR GJERMAN				PËRZIERJE NGA SHKRIRJA E METALEVE, LIDHJE
REOMIRI		NOTË MUZIKORE		
ATDHETARI SHQIPTAR, STAFI		PARAARDHËS TË ZELANDES SË RE		
Q				
AUTORI YNË, VRETO				
THIRRJE TELEFONIKE				
POETI NORVEGJEZ, HENRIK	I	AI QË BËN RILEVIME	VENDI I EMIRËVE	TEKST PROCESOR
VEPËR E SHEKSPIRIT				ELEKTRODË E POLIT POZITIV
M				BALERINA AMERIKANE, DANKAN
SERI E ANIMUAR, VEPËR E KARIKATURISTIT NE FOTO				
KËNGËTARJA JONË, FARA		AUSTRIA	QIRAJA PËR KALË (VJET) (SHQ.)	GRAMI
POETI SPANJOLL, PABLO				BANOR I HERSHËM I NJË KRAHINE, VENDESI
KOHA	AI QË PUNON ME VAGON			SHKRONJAT E PARA
	BËJ GJUMË			BIN LADEN
SERI E ANIMUAR, VEPËR E KARIKATURISTIT NE FOTO				"OSRAMI"
				POLITIKANI YNË, ALIU
LESOTO				
		LULE KACAVARRËSE		TEMPERATURA
		1000 ROMAK		INDIUMI
AKTORJA SHQIPTARE, AGOLLI				
				PERSIA

ZGJIDHJET: MAPA, AVON, TIRË, GOT, R. LA, QEMAL, JANI, I ANODA, MBRETI LIR, ZH, SIMPSONËT, ELI, A, C, AB, NERUDA, OSR, VAGONISTI, FUTURAMA, T, LE, JASEMIN, ESMÄ, IRANI.

Zemërimi ka shpërthyer në rrjetet sociale në Milano dhe është tepër i fortë, sepse dënon një akt të turpshëm vandalizmi. Qytetarët italianë janë irrituar teksa në një grafi në mur shohin figurat e dy gjyqtarëve heronj Falcone dhe Borsellino me armë në dorë. Gravura gjendet në zonën e Navigli, në murin e Porta Ticinese dhe është bërë në 2013 nga siciliani Tunus, i cili portretizon dy heronjtë e anti-mafies të përfaquar, ndërsa ditët e fundit dikush ka pikturuar një armë të kuqe në dorën e Falcones. Pistoleta i është drejtuar ballit të Borsellos. Ndër të parët që ka dënuar aktin e vandalizmit është Alvisio Salerno Ai shprehet: "Falcone dhe Borsellino, sot, kanë vdekur për herë të dytë (...) Milan, Italia si një e tërë, nuk mund t'i menaxhojë këto gjeste. Gjest i neveritshëm, që mund të fsheh diçka edhe më tragjike".



Falcone "qëllon" Borselinon, shpërthejnë rrjetet sociale në Itali

Frikë se i vidhnin çantën, gruaja kalon përmes skanerit me rreze X

A jeni shqetësuar ndonjëherë që gjërat tuaja mund të vidhen kur kaloni nëpër kontrolle sigurie?! Një grua në Kinë sigurisht që ka pasur. Një grua në Kinë këmbëngulte që ajo të ngjitej në një skaner me rreze X bashkë me çantën e saj në një stacion treni, sepse kishte frikë se mund t'ia vidhnin. Staf i sigurisë është tronditur kur ka parë siluetën e një gruaje ndërsa ata monitoronin ekranet me rreze X.



STUDIMI PËR TUMORET, ushqimi ndikon në përhapjen e tyre

Shkencëtarët e Kembrixhit pretendojnë se ka prova në rritje se ushqimi mund të ndikojë te rritja dhe përhapja e kancerit. Studime të zhvilluara te kafshët treguan se tumoret agresive të gjirit e ngadalësonin ndjeshëm përhapjen në mungesë të asparginës, përbërës ushqimor që gjendet te shpargu, mishi i shpendëve apo frutat e detit. Studimi i zhvilluar në Institutin e Kembrixhit për Kërkimet mbi kancerin u krye te minjtë me një formë agresive kanceri. Normalisht brejtësit do të kishin ngordhur brenda disa javëve, ndërsa

tumori përhapej në trup. Por, kur minjtë iu nënshtruan një diete që nuk përmbante asparginën, ose medikamenteve që e bllokoi atë, përhapja e tumorit u frenua. Aspargina është një aminoacid që e merr emrin nga shpargu. Shkencëtarët shpresojnë që në të ardhmen të shfrytëzojnë varësitë ushqimore për të përmirësuar trajtimet. Vitin e kaluar, një studim i Universitetit të Glasgou, tregoi se heqja e aminoacideve serine dhe glicine nga dieta ushqimore ngadalësonte përhapjen e limfomës dhe kancerit instestinal.

Kapuçino me... selfie




Përgatitja e kafesë, pijes së preferuar të nxehtë, shumë njerëzve në mbarë botën, çdo ditë u bëhet një sfidë gjithnjë e më e madhe, e cila kërkon mënyra për t'i impresionuar ata. Kështu, një kafene në Rotterdam ofron të ashtuquajturën "selfieçino", kapuçino ku ndodhet fotografia juaj. Pronarja e kafenesë, turkja Ahu Yasik Doganer, e lindur në Holandë, tregon se klientët vijnë nga të gjitha pjesët e Holandës për të provuar selfieçinon. "Gjithmonë kemi ëndërruar të hapim një kafene. Vitin e kaluar

gjatë pushimeve në Singapor vizitua një kafene që ofronte selfieçino, e cila ishte shumë interesante për ne. Më parë diçka të tillë kisha parë vetëm në rrjetet sociale", tha Doganer. Ajo shtoi se që atëherë e kishte kuptuar se diçka të tillë duhet të ofrohet në Holandë, kurse rreth idesë ka punuar me bashkëshortin dhe motrën e saj. Ajo shpjegoi se klientët që porositin selfieçinon duke bërë selfie përmes aplikacionit ose të dërgojnë ndonjë foto ose logo. Pas kësaj, aparati i kafesë printon foton që dërgohet përmes aplikacionit.

- 399 - Filozofi Sokrati dënohet me vdekje.
- 590 - Kisra II kurorëzohet mbret i Persisë.
- 1563 - Trupat ruse okupojnë Polotsk, Lituania.
- 1689 - Parlamenti gjerman i shpall luftë Francës.
- 1763 - Austria, Prusia dhe Saksونيا nënshkruajnë Paqen e Hubertusburgut.
- 1919 - Legjioni Amerikan organizohet në Paris.
- 1929 - Masakra e Shën Valentinit në Çikago.
- 1933 - Kandidati për kryetar Franklin Roosevelt mbijeton tentimin për vrasje.
- 1936 - Hitleri shpall konstruktimin e Volkswagen-it.
- 1942 - Singapori i dorëzohet Japonisë.
- 1984 - 500,000 ushtarë iranian futen në Irak.
- 1996 - Sulm ndaj Ambasadës amerikane në Athinë, Greqi.

Nëse fëmija zgjohet gjatë natës ju nuk duhet të bisedoni me të. E vetmja gjë që mund t'i thoni është: fli se është ende natë! Nëse fëmija zgjohet nuk duhet të ndizni dritë, pasi dhe një dritë sado e vogël mund të çorientojë gjumin e tij. Nëse do t'ju duhet që gjatë natës t'i ndërroni peleen, duhet ta bëni këtë në mënyrë të shpejtë dhe duke përdorur një pecetë të vakët, pasi në të kundërtën mund të zgjohet komplet. Nëse në dhomën ku fle fëmija hyn shumë dritë, atëherë mundohuni t'i vendosni grila ose perde të trasha. Pranë shtratit të fëmijës nuk duhet të ketë lodra. Ju mund t'i vendosni pranë vetëm një arushë të cilin mund ta përdorë si "shok gjumi". Nëse zgjohet gjatë natës nuk duhet të bëhet gati të luajë.



TRE MIQTË DHE FËMIJËT E TYRE

- Djali im me shumë gjasa do të bëhet avokat. Që tani përdor argumente shumë të holla!
- Djali im do të bëhet veteriner, thotë i dyti, që tani ka filluar të vizitojë kafshët!
- Im bir me siguri do të bëhet kamerier kur të rritet. Sa herë e thërras, asnjëherë nuk vjen...



Kuptimi i vetëm i jetës është që t'i shërbejë njerëzimit.
(LEON TOLSTOI)